



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Juridik”
i
“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Evis Alimehmeti

Prof. Asoc. Dr. Enkelelda Ollidashi

Dhjetor 2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bsc në "Juridik"

Nr.		
1	IAL aplikues:	"Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Juridik
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 225, datë 04.06.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër 367
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMASh Nr. 344, datë 17.09.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli 1
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE/ 3 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2018-2019 (40 studentë) v.a 2019-2020 (73 studentë) v.a 2020-2021 (43 studentë) 156 studentë (për një cikël të plotë studimi)
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Juridik” është program tre vjecar studimi me 180 ECTS (60 ECTS në cdo vit akademik). Ky program studimi është licensuar me Urdhërin nr.225, date 04.06.2013, të ministries së Arsimit dhe Shkencës. Programi i studimit Bachelor në “Juridik” është vlerësuar /akredituar nga APAAL me Vendimin Nr.71, datë 27.07.2015.

Programi i studimit Bachelor në “Juridik” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (si njësia kryesore) dhe nga Departamenti i të Publike & Civile (si njësitë bazë). Staf i akademik i të dy njësive bazë (dep.civil & dep.publik) është i angazhuar në realizimin e procesit mësimor të këtij program studimi. Objektivi kryesor i këtij program studimi është përgatitja e studentëve me njohuri në fushën e të drejtës publike dhe private dhe në shkencën juridike në tërësi. Kompetencat teorike dhe praktike që ky program studimi ofron mundësojnë punësimin e studentëve si në sektorin privat si p.sh. Zyra avokatie, zyra noterie, zyra përmbarimi etj), ashtu dhe në sektorin publik.

Studentët që përfundojnë studimet në këtë program studimi kanë të drejtë të vijojnë studimet e tyre në ciklin e dytë të studimeve (Msc). Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ofron për studentët që mbarojnë këtë program studimi vijimin e tyre në Master Shkencor në të Drejtën Civile dhe Tëgtare dhe Master Shkencor në të Drejtën Publike.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, Arjana Aliaj.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përbushen;
- Standardet përbushen pjesërisht;
- Standardet përbushen kryesisht;
- Standardet përbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Evis Alimehmeti dhe Prof. Assoc. Dr. Enkelelda Olldashi, eksperte (të caktuar me Urdhërin Nr. 39, datë 08.06.2021), Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga Arjana Aliaj, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion.

Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion, të zhvilluar në datë 01- 02 Korrik 2021 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga UMSH në ofrimin e një programi të mirë Bachelor në Shkenca Juridike (aktualisht i riorganizuar), gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Me vendimin Nr. 71, datë 27.07.2015, nga Këshilli i Akreditimit janë lënë këto rekomandime:

1. Të përmirësojë cilësinë e studentëve në hyrje, duke përfshirë dhe këtu dhe njohjen e gjuhës së huaj, pasi mungesa e njohjes së saj ndikon në uljen e standardit të mësimdhënies dhe vështirësinë në përdorimin e e literaturës bashkëkohore.

Në lidhje me këtë rekomandim GVJ mendon që nuk është më relevant, meqenëse nota mesatare në hyrje të studentëve është e përcaktuar nëpërmjet akteve nënligjore.

2. Të bëhen përpjekje konkrete për përmirësimin e aftësive analitike dhe të shkrimit akademik nga ana e studentëve, duke rritur standardin e kërkesës për ato lëndë që japin këto aftësi.

Në lidhje me këtë rekomandim GVJ konstaton (evidenca 18/tabela 10 & 11):

- a. Në programin e studimit Bachelor në “Juridik” është përfshirë në planin mësimor lënda “Shkrimi Akademik” (me 6 ECTS/30 orë leksione & 30 orë seminare). Kjo lëndë ofrohet në vitin e parë akademik (semestri i dytë) dhe është klasifikuar në grupin e lëndëve të formimit të përgjithshëm (kategoria A).
- b. Në këtë program studimi janë përfshirë dhe lëndët të cilat mundësojnë aftësimin e studentëve me njohuri teknologjike dhe analitike si : lënda “Sociologjia e ligjit” (me 5 ECTS) – në grupin e kategorise se lëndëve të formimit të përgjithshëm (A); lënda “Informatika” (me 6 ECTS)- në grupin e kategorisë së lëndëve plotësuese (D).

GVJ e konsideron të plotësuar plotësisht këtë rekomandim.

3. Të marrë masa konkrete për rritjen e stafit të specializuar për gjenerimin dhe diversifikimin e burimeve të fondeve në funksion të këtij programi.

Në lidhje me këtë rekomandim GVJ konstaton (evidenca 13.3):

Personeli akademik (PAE & PAK) i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur akademik dhe eksperiencën e përshtatshme e profesionale. Institucioni punon dukshëm për të afruar personel akademik me edukim në institucione arsimore jashtë vendit e me kualifikime në lidhje me programin e studimit. Në programin e studimit janë angazhuar si staf akademik me kontratë: gjyqtarë, pedagogë nga universitete të tjera publike të vendit, etj. GVJ nxit Institucionin që në politikën e tij të rekrutimit të PAK, të vazhdojë përpjekjet positive të dy viteve të fundit akademike për të minimuar rastet e angazhimit në mësimdhënie të personelit akademik me profil të largët profesional në disiplina ligjore përkatëse.

GVJ e konsideron të plotësuar plotësisht këtë rekomandim.

“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.09.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 85/31 Prot, datë 27.09.2021. “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 958/1 Prot, datë 22.10.2021, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor "Juridik"

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në "Juridik", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare/Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë", synon përgatitjen dhe aftësimin e studentëve në fushën e së drejtës dhe nxitjen e tyre për të kontribuar në konsolidimin e shtetit ligjor në vend.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Aktet themeltare të UMSH (evidenca 1 "Statuti" & evidence 2 "Rregullorja e Organizimit") kanë të përcaktuar mënyrën e përmbushjes së misionit akademik të institucionit, përmes ruajtjes dhe promovimit të vlerave/interesave kombëtare. Ky qëllim është dhe pjesë e strategjisë së zhvillimit të institucionit (evidenca 6 "Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH").			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Juridik" ka të përcaktuar prioritetet e këtij program, të cilat janë të lidhura me qëllimin dhe misionin e institucionit në tërësi (evidenca 5 "Rregullorja e programit Bachelor në Juridik").			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor në "Juridik" me 180 ECTS (me kohë të plotë/3 vite akademike), i cili ofrohet nga Departamenti i të Drejtës Civile dhe Publike, përmban lëndë të cilat mundësojnë ofrimin e njohurive në fushën e së drejtës së brendshme/kombëtare ashtu dhe në atë ndërkombëtare. Përmbajtja e kurrikulës së këtij program studimi përmes ofrimit të nojurive bazë në fushën e së drejtës, synon të nxisë tek studentët aftësitë interpretuese të legjislacionit të brendshëm në aspektin e harmonizimit të tij me parimet dhe standartet ndërkombëtare. Ky aspekt realizohet përmes metodave të mësimdhënies, të cilat janë në funksion të realizimit dhe të misionit të programit dhe institucionit (evidenca 7 "Strategjia e Zhvillimit të Programit Bachelor në Juridik").			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit dhe strategjia e programit të studimit Bachelor në “Juridik” (evidenca 6 & 7), kanë të mirëpërcaktuar prioritetet akademike UMSH. Si pjesë e programeve të studimeve të ofruara nga UMSH është dhe programi i studimit në ciklin parë në “Juridik”, i cili synon të mundësojë realizimin e misionit të institucionit për përgatitjen dhe aftësimin e studentëve me njohuri në fushën e së drejtës dhe në aplikimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Rregullorja e institucionit (UMSH) dhe ajo e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (njësia kryesore për programin e studimit Bachelor në “Juridik”), kanë të mirëpërcaktuara zbatimin e prioritetëve strategjike të institucionit (evidenca 2 & 3). Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në “Juridik” është pjesë e strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe mundëson zbatimin e prioritetëve të tij nga ana e strukturave përgjegjëse për realizimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet e tyre (evidenca nr. 7).</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik” ofrohet nga Departamenti i të Drejtës Civile dhe Publike, si njësitë bazë përgjegjëse për këtë cikël studimesh. Programi është i organizuar në tre vite akademike me 180 ECTS (me kohë të plotë); 60 ECTS për cdo vit akademik; viti akademik është i organizuar në dy semestra (30 javë mësimore); 3000 orë studimi, nga të cilat 1765 orë studimi në auditor dhe 2565 orë studimi individuale (evidenca 5 “Rregulore e programit të studimit”).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik” është në përputhje me emërtimin dhe fushën akademike/kërkimore të dy njësive bazë përgjegjëse, të cilat janë pjesë e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (njësia kryesore).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Institucioni (UMSH), përmes rregulloreve të programeve të studimit që ofron, mirëpërcakton objektivat e cdo programi studimi si dhe strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e këtyre objektivave. Programi i studimit Bachelor në “Juridik”, në rregulloren përkatëse (evidenca 5), përcakton objektivat akademike dhe shkencore të këtij programi, të cilat synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pajisjen e studentëve me njohitë bazë në fushën e së drejtës; - aftësimin e studentëve për aplikimin në praktikë të njohurive juridike; - nxitjen e studentëve për interpretimin në praktikë dhe në mënyrë të pavarur të njohurive në shkencën juridike; - studimin teorik dhe aplikativ në fushën e të drejtës në funksion dhe të nevojave të tregut të punës.
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet</p>	


<p>të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik”, mundëson punësimin e studentëve në sektorin privat dhe publik si dhe vijimësinë e studimeve në ciklin e dytë të studimeve si në të drejtën publike ashtu dhe në të drejtën private (<i>evidenca 13.1 & evidenca 13.2</i>).</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si njësi kryesore që ofron këtë program studimi, ka kryer analizën e tregut të punës (për vitet akademike 2017-18; 2018-19 & 2019-20), në lidhje me të punësuarit në profesionin e juristit në sektorin publik dhe privat, të tillë si: administrata publike, noteria, avokatia/zyra juridike, biznesi i vogël dhe shoqatat (<i>evidenca 16</i>). Përmes kësaj analize janë evidentuar disa të dhëna zyrtare të marra nga faqet përkatëse të institucioneve të mësipërme. Analiza ka mundësuar për njësinë përkatëse një qasje më akademike drejt nevojave konkrete të tregut të punës në fushën përkatëse (<i>evidenca 16, fq.4</i>).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik”, ofrohet nga dy prej njërive bazë të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare: Departamenti i të Drejtës Civile dhe Publike. Ky program studimi ka si objektiva kryesore: aftësimin profesional të studentëve për të punuar në sektorin publik dhe privat. Objektivat realizohen përmes ofrimit të lëndëve që mundësojnë njohuri në fushën e të drejtës publike dhe private si dhe lëndëve që ofrojnë njohuri juridike në të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare (<i>evidenca 13.1 “Plani mësimor” & 3.2 “Programet e lëndëve”</i>).</p>											
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="639 929 839 987">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="839 929 1038 987">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1038 929 1238 987">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1238 929 1406 987">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="639 987 839 1032"></td> <td data-bbox="839 987 1038 1032"></td> <td data-bbox="1038 987 1238 1032"></td> <td data-bbox="1238 987 1406 1032" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>				Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
			X									

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Juridik”. Kjo njësi kryesor përbëhet nga tre njësi bazë: Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Publike dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p> <p>Stafi akademik (PAE & PAK) sipas departamenteve përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i të Drejtës Civile ka në përbërjen e tij : për vitin akademik 2018-19 - 10 staf akademik PAE & 4 staf akademik PAK; për vitin akademik 2019-20 - 10 staf akademik PAE & 2 staf akademik PAK; për vitin akademik 2020-21 - 9 staf akademik PAE & 4 staf akademik PAK. - Departamenti i të Drejtës Publike ka në përbërjen e tij : për vitin akademik 2018-19 - 9 staf akademik PAE & 6 staf akademik PAK; për vitin akademik 2019-20 - 13 staf akademik PAE & 1 staf akademik PAK;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>për vitin akademik 2020-21 - 13 staf akademik PAE & 45staf akademik PAK.</p> <p>- Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërjen e tij :</p> <p>për vitin akademik 2018-19 - 9 staf akademik PAE & 5 staf akademik PAK;</p> <p>për vitin akademik 2019-20 - 11 staf akademik PAE & 1 staf akademik PAK;</p> <p>për vitin akademik 2020-21 - 12 staf akademik PAE & 4 staf akademik PAK (evidenca 18, tabela. 1 "Stafi akademik për cdo njësi bazë).</p> <p>Institucioni ka kapacitetet duhura për realizimin e këtij programi studimi, pasi personeli akademik (PAE & PAK) i dy njësive bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka numrin dhe aftësitë e duhura akademike dhe profesionale për realizimin e përbajtjes së kurrikulës së këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Juridik" është i organizuar në tre vite akademike (180 ECTS) dhe është pjesë e programeve të studimit që ofrohen nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (si njësia kryesore).</p> <p>Fusha akademike e këtij programi studimi është e lidhur me fushën akademike të studimit që ofron njësia kryesore dhe përbajtja e lëndëve lidhet me fushat që mbulohe nga dy daparamentet përgjegjëse (si njësitë bazë).</p> <p>Përkatesisht lëndët në fushën e të drejtës publike/penale mbulohe nga stafi akademik i Departamentit të Drejtës Publike dhe lëndët në fushën private nga Departamenti i të Drejtës Civile (evidenca 5 "Rregullore e programit të studimit"; evidenca 4 & 4.1 "Rregulloret e Dep.civil & Dep.publik").</p> <p>Ne programin e studimit Bachelor në "Juridik" janë gjithsej 22 lëndë, nga të cilat rreth 12 lëndë/module janë në fushën e të Drejtës Publike (në fushën e të drejtës penale janë rreth 4 module) dhe rreth 8 lëndë /në fushën e të drejtës Civile (evidenca 13.2 "Syllabuset e lëndëve" & evidenca 18/tabela 9 "Plani mësimor sipas veprimtarive formuese").</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>				
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5



Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në rregulloren e organizimit të institucionit UMSH (evidenca 2); në rregulloren e njësisë kryesore FSHMN (evidenca 3); në rregulloren e Departamentit të Drejtës Civile dhe Publike (evidenca 4 & 4/1) janë të mirëpërcaktuara detyrat dhe ndërveprimi ndërmjet strukturave akademike dhe atyre ndihmëse akademike. Organizimi institucional mundëson vendimmarrjen që bazohet në respektimin e njësive bazë dhe kryesore. Procedurat e vendimmarrjeve janë të mirëpërcaktuara në dokumentat bazë të institucionit (evidenca 1 "Statuti i UMSH & evidence 2 "Rregullore e organizimi te UMSH).</p>

Adresa: "Fruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit (<i>evidenca 19</i>). Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, si njësi kryesore ku ofrohet programi i studimit Bachelor në “Juridik” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale (<i>evidenca 18, tabela 5</i>).</p> <p>Për këtë program studimit Bachelor në “Juridik”, marrëveshjet e bashkëpunimi janë me institucionet publike dhe private për realizimin e objektivave formuese për studentët dhe për realizimin e praktikave profesionale (<i>evidenca 18/ tabela 5</i>). Marrëveshjet e bashkëpunimit të njësisë bazë synojnë dhe ofrimin e studentëve të mundësisë së punësimit pas diplomimit. Realizimi i mundësisë së punësimit të studentëve mundësohet edhe përmes zyrës së koordinimit dhe mbështetjes së studentëve, e cila ofroj informacione për punësimin e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare (si njësi kryesore) harton raporte vjetore analitike mbi punën e njësisë (<i>evidenca 22 “Analizë vjetore e FSHJMN</i>). Kjo njësi kryesore harton dhe raportin e vlerësimit mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet përkatëse (<i>evidenca shtesë 1 “Analizë mbi përfitimin e Marrëveshjeve të bashkëpunimit”</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Nësia kryesore bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Juridik” (Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare) ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me: Akademinë e Shkencave; Ministrinë e Drejtësisë; Gjykatën e shkallës së parë të rrethit gjyqësor Tiranë; Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit; Dhomën Kombëtare të Noterisë; Komisioneri për të drejtën e informimit; zyra noteriale, zyra avokatie, organizata të shoqërisë civile, për realizimin e objektivave formuese për studentët dhe për realizimin e praktikave profesionale (<i>evidenca 18/tabela 5</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni (UMSH) ka zhvilluar aktivitetet përkatëse, në lidhje me trajnimin profesional të studentëve për përfshirjen e tyre në tregun e punës, duke krijuar dhe strukturat të posacme për këtë qëllim (<i>evidenca shtesë 7 “Krijimi i Bordit të tregut të punës”</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR



Standardi II.1				
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).		Bazuar në rregulloren e programit të studimit (<i>evidenca 5</i>), programi i studimit Bachelor në "Juridik" është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve ECTS. Ky program studimi është i organizuar në pesë fusha kryesore të veprimtarisë akademiko-mësimore (<i>evidenca 18/tabela 9</i>):		
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.		A. LËNDËT E FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (A) – 6 lëndë/module me 31 ECTS gjithsej; lëndët/modulet kanë nga 4 deri në 6 ECTS;		
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.		B. LËNDËT KARAKTERIZUAESE/SPECIFIKE TË PROGRAMIT (B) – 19 lëndë/module me 97 ECTS ; lëndët/modulet kanë nga 4 deri në 7 ECTS;		
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.		C. LËNDËT NDËSDISCIPLINORE/INTEGRUESE ME ZGJEDHJE (C) – 6 lëndë me 24 ECTS ; lëndët kanë nga 4 deri në 8 ECTS;		
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.		D. LËNDËT PLOTËSUESE (D) – 4 lëndë/module me 20 ECTS ; lëndët/modulet kanë nga 4 deri në 6 ECTS;		
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.		E. Lëndët/detyrimet përmblyëse (E) – Provimi përmblyës me 8 ECTS .		
		Përmbajta e këtij programi studimi mundëson (<i>evidencat 13</i>):		
		<ul style="list-style-type: none"> - Formimin e përgjithshëm të studentëve në fushën e së drejtës, përmes lëndëve të ofruara kryesisht në vitin e parë akademik si p.sh., në lëndët "Sociologjia e Ligjit", "E drejta romake", "Historia e Shtetit dhe së Drejtës", "Shkrim Akademik"; - Njohuri specifike në fushën e të drejtës private, përmes lëndëve të ofruara në vitin e dytë dhe të tretë akademik si p.sh., në lëndët "E drejta civile I & II", "E drejta familjare", "E drejta e punës", "E drejta e biznesit", "E drejta ndërkombëtare private" etj; - Njohuri specifike në fushën e të drejtës publike, përmes lëndëve të ofruara përgjatë të tre viteve akademike të studimit si p.sh., në lëndët "E drejta publike", "E drejta kushtetuese", "E drejta administrative", "E drejta ndërkombëtare publike I & II" etj; - Njohuri në të drejtën europiane, përmes lëndëve të ofruara në vitin e dytë dhe të tretë akademik si p.sh., në lëndët "E drejta europiane" dhe "Historia politike e europës dhe integrimi europian"; - Njohuri praktike, përmes lëndës së praktikës. 		
		Të gjitha lëndët e këtij programi kanë të përcaktuar elementet/komponentët e vlerësimit/kontrollit të dijeve sipas ndarjes (<i>evidenca 18/tabela 13 "Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies"</i>) në orë leksioni në auditor (1020 gjithsej); orë seminaresh (855 gjithsej); ushtime/laboratorë (30 orë gjithsej); forma të kontrollit (120 orë gjithsej).		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Sipas Statutit të UMSH (<i>evidenca 1</i>), njësia kryesore pvr programin e studimit bachelor në “Juridik” është Fakulteti i Shkencave juridike dhe ‘Marrëdhënieve Ndërkombëtare’, i cili drejtohet nga dekani që mban titullin Prof. Kjo njësi kryesore, përbëhet nga tre njësi bazë ku dy prej tyre janë përgjegjëse për këtë program studimi (Departamenti i të Drejtës Civile dhe Publike).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Drejtuesit e njësive bazë mbajnë Gradën Shkencore Dr dhe detyrat e tyre janë të mirëpërcaktuara në statutin dhe rregulloren e organizimit të UMSH (<i>evidenca 1 & 2</i>). Njësitë bazë janë të organizuara sipas statutit dhe rregulloreve përkatëse (<i>evidenca 1, 4 & 4/1</i>). Cdo njësi bazë ka drejtuesin përkatës dhe në mbështetje të realizimit të misionit të njësisë kryesore është caktuar dhe personin që kryen funksionin e koordinimit. Koordinatori ndihmon dhe në realizimit e misionit/detyrave të njësive bazë, duke koordinuar punën ndërmjet këtyre njësive (<i>sipas RB-së fq.17 dhe evidencës 2 & 3 (nemi 21)</i>).
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Programi i studimit Bachelor në “Juridik” realizohet nga stafi akademik (PAE & PAK) që është pjesë e dy departamenteve përgjegjëse (Dep.Civil & Publik). Në përbërje të këtyre njësive janë të angazhuar pedagogë që mbajnë tituj/gradë shkencore si dhe asistentë në proces Doktorature apo me Msc.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Numri i personelit akademik të angazhuar është brenda kriterëve të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Ky numër është përkatësisht (<i>evidenca 18/tabela 7</i>):
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2015-2016 – 2 Prof.Asoc (PAE) & 1 Prof.Asoc (PAK); 7 lektorë me gradën shkencore Dr (PAE) & 5 (PAK); në proces doktorature 5 (PAE) & 1 (PAK); me Msc 7 (PAE) & 0 (PAK)- raporti është 21 PAE/7 PAK; - për vitin akademik 2016-2017 – asnjë me titullin Prof (PAE) & 1 Prof (PAK); 2 Prof.Asoc (PAE) & 2 Prof.Asoc (PAK); 6

	<p>lektorë me gradën shkencore Dr (PAE) & 7 (PAK); në proces doktore 4 (PAE) & 0 (PAK); me Msc 7 (PAE) & 1 (PAK)- raporti është 19 PAE me 11 PAK;</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin akademik 2017-2018 – 2 me titullin Prof (PAE) & 1 Prof (PAK); 3 Prof.Asoc (PAE) & 1 Prof.Asoc (PAK); 11 lektorë me gradën shkencore Dr (PAE) & 3 (PAK); në proces doktore 2 (PAE) & 0 (PAK); me Msc 11 (PAE) & 1 (PAK)- raporti është 29 PAE me 6 PAK; - për vitin akademik 2018-2019 – 2 me titullin Prof (PAE) & 1 Prof (PAK); 3 Prof.Asoc (PAE) & 2 Prof.Asoc (PAK); 11 lektorë me gradën shkencore Dr (PAE) & 1 (PAK); në proces doktore 2 (PAE) & 1 (PAK); me Msc 4 (PAE) & 2 (PAK)- raporti është 22 PAE me 6 PAK; - për vitin akademik 2019-2020– 2 me titullin Prof (PAE) & 1 Prof (PAK); 3 Prof.Asoc (PAE) & 0 Prof.Asoc (PAK); 15 lektorë me gradën shkencore Dr (PAE) & 0 (PAK); në proces doktore 1 (PAE) & 0 (PAK); me Msc 6 (PAE) & 1 (PAK)- raporti është 27 PAE me 3 PAK; - për vitin akademik 2020-2021 – 1 me titullin Prof (PAE) & 0 Prof (PAK); 2 Prof.Asoc (PAE) & 2 Prof.Asoc (PAK); 10 lektorë me gradën shkencore Dr (PAE) & 0 (PAK); në proces doktore 1 (PAE) & 0 (PAK); me Msc 2 (PAE) & 1 (PAK)- raporti është 16 PAE me 3 PAK. 			
	<p>Departamenti i të Drejtës Civile dhe Publike, si dy njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Juridik” kanë në përbërjen e tyre dhe në funksion të këtij programi studimi stafin akademik (PAE & PAK) është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin akademik 2015-16 - 21staf akademik PAE & 7 staf akademik PAK; - për vitin akademik 2016-17 - 19 staf akademik PAE & 11 staf akademik PAK; - për vitin akademik 2017-18 - 29 staf akademik PAE & 6 staf akademik PAK; - për vitin akademik 2018-19 - 22 staf akademik PAE & 6 staf akademik PAK; - për vitin akademik 2019-20 – 27 staf akademik PAE & 3 staf akademik PAK; - për vitin akademik 2020-21 - 16 staf akademik PAE & 3 staf akademik PAK <p>(Evidenca 18/tabela 6 “Të dhëna për stafin akademik”).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtar (si njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi), ofron informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. Informacioni lidhet me programet mësimore të lëndëve/moduleve dhe komponentët/elementet përkatëse mësimore.</p>			
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivite formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik”, i cili ofrohet nga njësitë bazë Dep.Civil & Publik, përmban emërtimin e lëndëve, kreditet përkatëse, numrin e orëve mësimore në auditor dhe ato të punës individuale të studentëve, titullarët e lëndëve dhe elementët e tjerë të programit të cdo lënde (<i>Evidenca 13.1 & 3.2</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Juridik” është i organizuar në 3-vite akademike (6 semestra) me 180 ECTS. Cdo vit akademik është i organizuar në dy semestra më 30 ECTS për cdo semestër. Ky program studimi përbëhet nga 22 lëndë, pa përfshirë praktikën dhe provimin e formimit. Lëndët janë të grupuara në 6 kategori: lënda të formimit të përgjithshëm (A)– 31 ECTS; lëndë të formimit karakterizues me (B) 97 ECTS; lëndë të ndërdisiplinore (C) me 24 ECTS; lëndë për përfitimin e aftësive plotësuese (D) si gjuhë e huaj, informatika dhe praktika profesionale me 20 ECTS; lëndë përmbyllëse (teza e provimi i formimit) me 8 ECTS (<i>evidenca 18/tabela 9</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Cdo lëndë në këtë program studimi përban qëllimin, objektivat, elementet e kontrollit të dijeve, temat e leksioneve dhe seminareve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, si dhe informacionet që lidhen me numrin e krediteve, numrin e orëve në auditor dhe individuale të studimit, emrin e titullarit, vitin dhe semestrin ku lënda përkatëse zhvillohet (<i>evidenca 13.1 & 3.2</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekvivalentimit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen nga departamentet dhe pedagogët përkatës për përmbajtjen e planin mësimor dhe përmbajtjen e cdo lënde në fillim të vitit/semestrit akademik.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në rastin e lëndëve me zgjedhje, pedagogët përkatës organizojnë takimin informuar mbi përmbajtjen e këtyre lëndëve, për t’iu dhënë mundësi studentëve në zgjedhjen e tyre (<i>nga minutat e takimit në institucion</i>).</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse për këtë program studimi miratojnë cdo vit akademik syllabuset e lëndëve dhe i bëjnë ato publik në faqen zyrtare dhe përmes broshurave informuese përkatëse (sipas RVB-së fq.18). Pedagogët përmirësojnë dhe rishikojnë programet e lëndëve në lidhje me literaturën e nevojshme apo komponentët e tjerë akademik (<i>nga minutat e takimit të GVJ-së në institucion</i>)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Standardi II.4</p>				
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>				

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në "Juridik" përbëhet nga 180 ECTS dhe përmban 4500 orë mësimore, nga të cilat: 2041 janë orë studimi në auditor dhe 2459 orë studimi individuale (evidenca 18/tabela 10 & 13). Programi është i organizuar në dy semestra akademik, përgjatë një vit akademik (15 javë mësimore për cdo semestër).			
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve/moduleve përputhen me fushën e studimit të këtij programi. Syllabuset e lëndëve në programin e studimit Bachelor në "Juridik" përbajnë: numrin e krediteve, numrin e orëve në auditor dhe atyre individuale të studimit, emrin e titullarit dhe titullin/gradën shkencore, vitin dhe semestrin ku lënda përkatëse zhvillohet, qëllimin, objektivat dhe rezultatet e prithsme të të nxënit, konceptet themelore mbi bazën e të cilave lënda përkatëse zhvillohet, elementet e kontrollit të dijeve, temat e leksioneve dhe seminareve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, si dhe informacionet që lidhen me (evidenca 13.1 & 3.2).			
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të prithsme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Organizimi i programit të studimit sipas ndarjes në pesë disiplina/veprimtari formuese (A-D), është brenda kriterëve të përcaktuara në aktet përkatëse nënligjore në fushën e arsimit. Shpërndarja e krediteve sipas disiplinave/veprimtarive përkatëse është në një raport të përshtatshëm për këtë cikël studimi. Raporti i lëndëve teorike dhe praktike është i përshtatshëm dhe mundëson për studentët marrjen e informacionit të nevojshëm teorik dhe praktik. Në këtë program studimi (Bachelor në "Juridik") lëndët e ofruara janë kryesisht lëndë të karakterit teorik dhe ato janë në masën 70% dhe ofrohen gjatë të tre viteve akademike; lëndët e karakterit praktik janë në masën 30% dhe ofrohen kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë akademik (evidenca 18/tabela 10 "Plani mësimor").			
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Raporti i lëndëve teorike dhe praktike është i përshtatshëm dhe mundëson për studentët marrjen e informacionit të nevojshëm teorik dhe praktik. Në këtë program studimi (Bachelor në "Juridik") lëndët e ofruara janë kryesisht lëndë të karakterit teorik dhe ato janë në masën 70% dhe ofrohen gjatë të tre viteve akademike; lëndët e karakterit praktik janë në masën 30% dhe ofrohen kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë akademik (evidenca 18/tabela 10 "Plani mësimor").			
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Kontrolli i dijeve është i ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e pjesëshme dhe provimin përfundimtar. Provimi përfundimtar zë 40% të vlerësimin total, ndërsa komponentët e tjerë janë në masën 60%: 10% pjesëmarrja në auditor, 20% detyra dhe 30% provimi i pjesshëm (evidenca 18/tabela 15 "Forma e kontrollit të njohurive").			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Provimet zhvillohen me shkrim, me gojë ose të kombinuara (evidenca 3 (neni 39)).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Përmbajtja e këtij programi i studimi mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë (Master Profesional ose Master Shkencor), si dhe punësimin e tyre në sektorët përkatës të tregut të punës (ku kërkohet vetëm një diplomë në ciklin e parë si p.sh., asistent në zyra avokatie apo noterie).			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me prithshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (si njësi kryesore që ofron këtë program studimi), ka kryer analizën e tregut të punës për vitet akademike 2017-18; 2018-19 & 2019-20, duke analizuar në lidhje me të punësuarit në profesionin e juristit në sektorin publik dhe privat (evidenca 16). Përmes kësaj analize është mundësuar (për njësinë përkatëse) një qasje akademike drejt nevojave konkrete të tregut të punës në fushën përkatëse (evidenca 16, fq.4).			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Juridik”, nga të dhënat që gjenden në <i>evidencën 18/tabela 4 “Ngarkesa totale e personelit akademik sipas viteve”</i>, rezultojnë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2015-2016 – stafi akademik (PAE) ka realizuar rreth 1200 orë në auditor + rreth 500 ore në bashkëpunim me stafin PAK, ndërsa stafi akademik PAK ka realizuar rreth 240. Për sa më sipër, nga rreth 2040 orë gjithsej për këtë program studimi, rezultojnë që stafi PAE ka realizuar për këtë vit akademik rreth 70% të ngarkesës mësimore; - Për vitin akademik 2016-2017 – stafi akademik (PAE) ka realizuar rreth 500 orë në auditor + rreth 900 ore në bashkëpunim me stafin PAK, ndërsa stafi akademik PAK ka realizuar rreth 420. Për sa më sipër, nga rreth 2040 orë gjithsej për këtë program studimi, rezultojnë që stafi PAE ka realizuar për këtë vit akademik rreth 60% të ngarkesës mësimore; - Për vitin akademik 2017-2018 – stafi akademik (PAE) ka realizuar rreth 400 orë në auditor + rreth 980 ore në bashkëpunim me stafin PAK, ndërsa stafi akademik PAK ka realizuar rreth 170. Për sa më sipër nga rreth 2040 orë gjithsej për këtë program studimi, rezultojnë që stafi PAE ka realizuar për këtë vit akademik rreth 60% të ngarkesës mësimore; - Për vitin akademik 2018-2019 – stafi akademik (PAE) ka realizuar rreth 920 orë në auditor + rreth 700 ore në bashkëpunim me stafin PAK, ndërsa stafi akademik PAK ka realizuar rreth 280. Për sa më sipër nga rreth 2040 orë gjithsej për këtë program studimi, rezultojnë që stafi PAE ka realizuar për këtë vit akademik rreth 67% të ngarkesës mësimore; - Për vitin akademik 2019-2020 – stafi akademik (PAE) ka realizuar rreth 1100 orë në auditor + rreth 1000 ore në bashkëpunim me stafin PAK. Për sa më sipër nga rreth 2040 orë gjithsej për këtë program studimi, rezultojnë që stafi PAE ka realizuar për këtë vit akademik rreth 70% të ngarkesës mësimore. <p>Personeli akademik (PAE & PAK) i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur akademik dhe eksperiencën e përshtatshme e profesionale (evidenca 13.3). personeli akademik mundëson realizimin e orëve përkatëse laboratorike, në lëndët që kanë të përcaktuar në programin mësimor orë të tilla si p.sh., “Informatika” (<i>sipas programit të kësaj lënde evidenca 13.2</i>).</p>			
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.				
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.				
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1				
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Institucioni (UMSH) ka miratuar aktet përkatëse për nxitjen e përdorimit të metodave inovative dhe të përshtatshme në procesin mësimor në nivel institucional në formën e udhëzuesve dhe formularëve përkatës. Udhëzuesit mundësojnë për pedagogët (PAE & PAK) dhe studentët marrjen e informacioneve të nevojshme orjentuese mbi aplokimin e metodave inovative, si dhe ngarkojnë në të njëjtën kohë strukturat përkatëse akademike dhe administrative për aplikimin në praktikë të tyre (<i>evidenca 34 "Udhëzues mbi përdorimin e platformës të mësimi online"</i>)			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Institucioni ka hartuar dhe formularët përkatës për monitorimin dhe realizimin sipas standarteve të procesit të kontrollit të cilësisë së diplomës apo provimit të formimit (<i>evidenca 36 "Udhëzues për hartimin e tezës së provimit, evidenca 14 "Udhëzues për hartimin e diplomës"</i>).			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare (si njësi kryesore për programin e studimit Bachelor në "Juridik") ka hartuar dhe miratuar planin e punës për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor për vitin akademik 2020-21 (<i>evidenca 12 "Plan pune i FSHJMN për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor"</i>), dokument i cili mundëson jo vetëm kontrollin e e procesit mësimor, por dhe synon të evidentojë problematikat e hasura për kapërcimin e tyre në vijim. Ky plan pune është hartuar dhe në bashkëpunim dhe me njësinë e sigurimit të cilësisë (NJSBCZHK) dhe është i shtrirë përgjatë gjithë vitit kalendarik përkatës.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSBCZHK është një nga strukturat e institucionit që harton në mënyrë periodike raporte vjetore të monitorimit të procesit mësimor dhe raporton në lidhje me gjetjet/konstatimet përkatëse tek autoritet drejtues (<i>evidenca 21 "Raport vjetor monitorimi i NJSBCZHK"</i>). Kjo njësi vepron në bazë të një dokumenti/manual të hartuar nga institucioni për realizimin e procesit të monitorimit nga ana e kësaj strukture (<i>evidenca 33 "Manual i NJSBCZHK"</i>).			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni aplikon kontrollin mbi cilësinë e procesit mësimor edhe përmes vlerësimit të stafit akademik nga ana e drejtuesve të njësisive përkatëse dhe nga ana e studentëve (<i>evidenca 25 "Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti" & evidenca 24 "Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues"</i>). Aplikimi i kontrollit të cilësisë së mësimdhënies përmes kontrollit të dyfishtë (autoritet drejtues dhe student) rrit shkallën e transparencës dhe nxit stafin akademik drejt përmirësimit të vazhdueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies është në formën e leksioneve dhe seminareve, ndërsa në disa lëndë si p.sh., “Informatika”, forma e mësimdhënies është dhe në formën e orëve laboratorike. Sipas dokumentave që gjenden në sistem (<i>evidenca 18/tabela 13</i>), në lidhje me orët e mësimdhënies në auditor për programin e studimit Bachelor në “Juridik”: orë leksioni në auditor janë 1020 gjithsej; orë seminaresh janë 855 gjithsej; ushtime/laboratorë janë 30 orë gjithsej.</p>			
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Stafi akademik (PAE &PAK), në varësi të natyrës së lëndës (teorike apo praktike) aplikojnë metoda të ndryshme të mësimdhënies. Metoda e mësimdhënies është dhe në varësi të formës së kontrollit të dijeve. Në të gjitha lëndët forma e kontrollit të dijeve është dhe përmes ushtrimeve/detyrave të kursit – në masën 20 % (<i>evidenca 18/tabela 15</i>). Njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi organizojnë dhe aktiviteti akademike dhe shkencore në kuadër të rritjes së cilësi së procesit mësimor, përmes përfshirjes praktike të studentëve në këtë proces, si psh. pjesëmarrja në projektin “Gjyqi simulues, në GJEDNJ” (<i>evidenca shtesë 11 “Analiza vjetore e punës së DDC</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Stafi akademik (PAE & PAK) inkurajohet nga institucioni për të aplikuar metoda sa më efektive për kontrollin e dijeve dhe për të nxitur studentët drejt një mësimnxënies sa më të qëndrueshme (<i>RVB, fq.26</i>). Institucioni aplikon dhe forma të përshtatshme për studentët me nevoja të veçanta (<i>evidenca 20 “Rregullore për studentët me aftësi të kufizuara”</i>). Institucioni ndihmon dhe mbështet stafin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, përmes trajnimeve të ndryshme (<i>evidenca 15 “programi i trajnimeve 2020-21”</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik aplikon metodat e mësimdhënies dhe në varësi të natyrës së lëndës apo dhe objektivave përkatëse, të cilat janë pjesë e programit të cdo lënde. Objektivat e lëndës, si një ndër komponentët e programit të lëndës, janë të lidhura dhe me metodat e mësimdhënies. Lëndët që ofrojnë njohuri teorike dhe praktika, kanë të përcaktuar në programin e tyre tema mbi çështjet praktike, të cilat zhvillohen në formën e diskutimeve të hapura me studentët (<i>nga minutat e takimit në institucion të GVJ-së “takimi me stafin akademik” & evidenca 13.2</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Metodat e mësimdhënies janë të lidhura dhe me format e kontrollit të dijeve, duke aplikuar kontrollin e tyre në formën e testeve apo dhe të case study (<i>evidenca 13.2</i>). Për realizimin e metodave interaktive, stafi akademik krijon grupe të vogla studentësh, duke nxitur frymën e debatit dhe analizës ligjore (<i>RVB, fq.27-28</i>). Studentët mbështeten dhe inkurajohen për pjesëmarrjen në aktivitetet ekstrakurikulare të organizuara nga njësitë përkatëse të institucionit (<i>evidenca 18/tabela 22 “Aktivizimi i studentëve”</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Departamenti i të Drejtës Civile (si një ndër njësitë bazë, përgjegjës për këtë program studimi), ka mundësuar dhe pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet/projekte akademike për përfshirjen e tyre në aplikimin praktike të njohurive (pjesëmarrja në projektin “Gjyqi simulues, në GJEDNJ” (<i>evidenca shtesë 11</i>).</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Departamenti i të Drejtës Civile (si një ndër njësitë bazë, përgjegjës për këtë program studimi), ka mundësuar dhe pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet/projekte akademike për përfshirjen e tyre në aplikimin praktike të njohurive (pjesëmarrja në projektin “Gjyqi simulues, në GJEDNJ” (<i>evidenca shtesë 11</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Programi i studimit Bachelor në “Juridik” zhvillohet në ambiente mësimore të përshtatshme për provuesin mësimor. Ambjentet janë të pajisura me mjetet didaktike të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor nga ana e stafit akademik. Ambjentet janë të pajisura me sitemin e ngrohjes dhe ftohjes si dhe me ndruscimin e duhur (<i>evidenca 18/tabela 16 “Mjediset e fakultetit”</i>).
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Hapësirat e klasave të leksioneve dhe seminareve janë të përshtatshme për numrin e studentëve që janë pjesë e këtij programi studimi. Studentët kanë akses të përshtatshëm për hyrjen në ambiente mësimore. Në godinë janë të instaluar dhe mjetet kundra zjarrit.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Gjithashtu, godina është e përshtatshme dhe për aksesin e auditoreve nga studentët me aftësi të kufizuara. Institucioni ka marrë masat e duhura për furnizimin me ujë të vazhdueshëm dhe energji elektrike. Ambjentet higjieno-sanitare janë të mjaftueshme për stafin akademik dhe studentët.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Në programin e studimit Bachelor në “Juridik”, stafi akademik dhe studentët kanë akses të vazhdueshëm në mjetet didaktike informatike si kompjutera dhe mjetet audio vizive për zhvillimin e procesit mësimor dhe orëve të prezantimeve të detyrave të kursit. Këto mjete përdoren nga stafi akademik dhe për zhvillimin e konferencave të ndryshme apo orëve të hapura mësimore. Në ambiente të institucionit janë dhe laboratorët e informatikës dhe gjuhëve të huaja, të cilat janë në funksion të procesit mësimor (<i>evidenca 21</i>).
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Stafi akademik përcakton në programet e lëndëve literaturën bazë dhe të këshillueshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u bazuar dhe në gjëndjen e teksteve apo materialeve të tjera mësimore që janë në bibliotekën e institucionit. Stafi akademik kërkon pasurimin e bibliotekës me tekste apo materiale të tjera akademike në varësi të nevojave të tij apo të studentëve. Kjo literatura kërkohet nga stafi akademik dhe përcillet nga njësi bazë për realizimin e kërkesave (<i>RVB fq.29</i>).
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Literatura gjendet në bibliotekën e institucionit, në versionin hard copy dhe soft copy. Disa tekste akademike janë të dizhitalizuara dhe të përshtatshme për aksesimin nga ana e studentëve. Biblioteka e institucionit ka dhe programet online të literaturës (Questia), të cilat janë të aksesueshme për stafin dhe studentët (<i>evidenca 18/tabela 17</i>).
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për	Në bibliotekën e institucionit janë rreth 32700 titujsh librash në versionin elektronik (E-Books), të cilat aksesohen nga të gjithë studentët dhe stafit akademik në funksion të procesit mësimor dhe në funksion të veprimtarive shkencore. Titujt e librave janë lehtësisht të aksesueshëm, pasi janë të grupuar sipas fushave përkatëse të studimit (ekonomi, drejtësi, psikologji, etj).
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për	Në funksion të këtij programi studimi është dhe Klinika e Ligjit, e cila mundëson për studentët përvetësimin e njohurive teorike dhe ndërlidhjen e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	tyre me praktikën. Mjediset përkatëse akademike mundësojnë në mënyrë të vazhdueshme ofrimin për studentët të mundësisë për të aplikuar në praktikë njohuritë teorike të përvetësuara gjatë lëndëve përkatëse.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni aplikon një sistem informatik të përshtatshëm për procesin mësimor. Ky sistem është i aksesueshëm për stafin akademik dhe studentët përmes faqes zyrtare të institucionit. Institucioni aplikon dhe platformën G-suit, e cila ka rezultuar e përshtatshme për studentët dhe stafin akademik dhe në kushtet e pamundësisë për zhvillimin e procesit mësimor fizikisht në auditore. Personeli administrativ ka ndihmuar studentët dhe stafin për aksesimin dhe përdorimin efektiv të kësaj platforme dhe gjatë kësaj periudhe.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Institucioni përdor dhe faqen e brendshme elektronike të komunikimit midis stafit akademik dhe studentëve. Studentët pajisen me kodin e tyre personal për të aksesuar komunikimin me stafin akademik dhe administrativ dhe për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm. Në funksion të përdorimit të këtij komunikimi online, institucioni ka hartuar dhe udhëzuesin përkatës për stafin dhe studentët.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në programin e studimit Bachelor në "Juridik", në bazë të rregullores së këtij programi, vlerësimi përfundimtar zhvillohet në formën e provimi final. Stafi akademik përgatit literaturën e duhur për të ndihmuar studentët në përgatitjen për këtë provim final (nga minutat e takimit të GVJ-së në institucion me stafin akademik).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni (UMSH) përmes akteve të brendshme (Statuti & Rregulloja e organizimit) ka krijuar strukturat përkatëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Një nga këto struktura është njësia e sigurimit të cilësisë (NJSBCZHK), e cila vepron në nivel institucional, duke bashkërenduar punën e saj me njësitë kryesore dhe bazë të institucionit (evidenca 1 & 2). Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e cila është dhe njësia kryesore për programin e studimit Bachelor në "Juridik" ka miratuar planin e punës për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor për vitin akademik 2020-21 (evidenca 12), plan i cili mundëson kontrollin e procesit mësimor dhe synon të evidentojë problematikat e hasura gjatë këtij procesi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	NJSBCZHK harton në mënyrë periodike raporte vjetore të monitorimit të procesit mësimor gjetjet përkatëse i raporton tek autoritet drejtuese (evidenca 2). Rezultatet e monitorimit reflektohen në vlerësimin e punës së stafit akademik dhe ato më pas janë pjesë dhe e dosjes përkatëse të stafit (nga minutat e takimit në institucion të GVJ-së me zyrën e burimeve njerëzore & evidenca shtesë ... "vlerësimi i performancës dhe zhvillimit profesional të punonjësve"). Njësia vepron në bazë të një manual të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



	hartuar nga institucioni për realizimin e procesit të monitorimit (evidenca 33).			
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UMSH organizon konferenca shkencore kombëtare mbi çeshtjet publike (si p.sh. zhvillimet e qëndrueshme dhe politikat e zhvillimit të punësimit në vend, kriza e corona virusit – sfidat dhe efektet ekonomike dhe sociale, etj), duke mundësuar dhe pjesëmarrjen dhe përfshirjen e stafit akademik (faqa përkatëse ëeb) Institucioni organizon dhe leksione të hapura, Webinare, duke orfruar për stafin akademik dhe studentët mundësinë e debateve në nivel akademik (faqa web).			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni ndihmon dhe mbështet stafin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies. Njësitë përkatëse organizojnë trajnimeve të ndryshme në funksion të rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të procesit mësimor, duke zhvilluar tema të tilla si: metodika e mësimdhënies, njohja e kuadrit rregullator të institucionve, etj (evidenca 15). Trajnimet ofrohen në mënyrë të vecantë dhe për stafin e ri akademik (RVB, fq. 33).			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Stafi akademik (PAE & PAK) janë përgjegjës për realizimin e objektivave të programit të lëndëve përkatëse, duke rishikuar në mënyrë periodike syllabuset e tyre. Stafi ka liri akademike në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të lëndëve, duke aplikuar në raste të vecanta dhe metoda inovative të mësimdhënies, të cilat më pas janë dhe objekt i diskutimit në departament dhe mund të aplikohen/promovohen dhe nga anëtarët e tjerë të stafit akademik (RVB, fq. 34). Njësitë përkatëse evidentojnë angazhimin e tyre në procesin mësimor dhe përmes mbledhjeve përkatëse (evidenca shtesë 8 “Mbledhje e DDP për procesin metodat e mësimor”), por ato duhet të jenë dhe për çështje më specifike, të cilat lidhen me metodat e mësimdhënies (nëse të tilla evidentohen se duhet të aplikohen).			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ rekomandon institucionin/njësinë përkatëse që të evidentojë eksperimentat akademike në lidhje me aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, përmes raporteve përkatëse apo proces-verbaleve të mbledhjeve të njësisë, duke mundësuar për më tej pasqyrimin e tyre në formën e dokumenteve të vlefshme për institucionin, si në kuadrin e proceseve të akreditimit, ashtu dhe në evidentimin e punës së tij të brendshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni barton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në fillim të cdo semestri akademik, stafi informon studentët për përmbajtjen dhe elementet e përbërës të cdo lëndë, duke mundësuar marrjen e informacionit të nevojshëm paraprak nga studentët. Në këtë program studimi elementet e domosdoshëm për ofrimin dhe kontrollin e dijeve të studentëve si dhe literatura përkatëse është e lidhur me ofruarimin e njohurive dhe krijimin e aftësive të duhura profesionale për studentët.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Elementet e programit mësimor të çdo lënde janë: numri i orëve mësimore në auditor dhe orët e studimit individual, të shprehura në formën e krediteve ECTS. Në bazë të rregullores së programit të studimit (<i>evidenca 5</i>), 1 ECTS përbëhet nga 25 orë pune mësimore e ndarë në 10 orë pune në auditor dhe 15 orë pune të pavarur të studentit. Syllabuset e lëndëve përmbajnë; qëllimin/dhe objektivat e lëndës; konceptet themelore mbi të cilat ndërtohet programi mësimor; temat mësimore të leksioneve dhe seminareve; literaturën bazë dhe të këshillueshme; metodologjinë e mësimdhënies, format e kontrollit të dijeve të përcaktuar (<i>evidenca 12/2</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndara në komponentët: në: 10 % pjesëmarrje aktive në auditor, 20 detyra përgjate semestrit, 30% provim përgjatë semestrit dhe 40% provimi përfundimtar (<i>evidenca 18, tabela 15</i>). Kontrolli i dijeve realizohet përmes provimeve me shkrim dhe detyrave të kursit të përcaktuara nga pedagogët përkëtes të lëndëve. Për studentët me aftësi të kufizuara aplikohen format e përshtatshme në varësi të cilësive të vecanta të tyre (<i>evidenca 20</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Juridik”, ka të përcaktuar dhe format e kontrollit dhe testimit të dijeve të studentëve, proces i cili realizohet përgjatë dy semestrave akademik (<i>evidenca 5</i>). Studentët janë të njohur me rregulloren e programit të studimit dhe në mënyrë specifike dhe me procedurat e zhvillimit të provimeve apo testimit të njohurive përgjatë vitit akademik. Institucioni mundëson dhe testimin e njohurive të studentëve në formën elektronike.</p> <p>Njësitë bazë përgjegjëse ngrënë komisionin përkatës të provimit të çdo lënde, i cili përbëhet nga së paku dy pedagogët që zhvillojnë procesin mësimor dhe që janë përgjegjës për vlerësimin e tezës së provimit. Komisioni i mbikqyrjes së zhvillimit të provimit, përbëhet nga 2 pedagogë, të cilët janë përgjegjës për monitorimin e provimit dhe respektimin e procedurave të provimit, duke mundësuar elemenimin e formave të kopjimit apo mos kryerjes së provimit individualisht dhe në mënyrë të pavarur nga studentët (<i>evidenca 5</i>). Institucioni ka hartuar dhe udhëzuesit për procedurat dhe afatet e sezoneve të provimit të rregullt dhe atyre të ndërmjetme, të cilat informojnë srtudentët mbi këto procese (<i>evidenca 35 & 36</i>). Pedagogët përgjegjës për çdo lëndë/modul hartojnë tezat e provimit, të cilat miratohen nga drejtuesi i departamentit, dy ditë përpara datës së</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





	provimit. Institucioni ka mundësuar dhe aplikimin e sistemit elektronik të testimit të studentëve, për rritjen e transparencës së këtij procesi.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Stafi akademik i këtij programi studimi informon studentët për rezultatet e provimit, proces i cili realizohet dhe me mbështetjen e stafit ndihmës akademik. Tezat e korrigjuara të provimit përmbajnë pikët e fituara nga studentët dhe komentet përkatëse të nevojshme për një informim sa më korrekt dhe akademik të studentëve.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në nenin 49 të rregulloren e njësisë kryesore (FSHJMN) është përcaktuar struktura përkatëse që merr masat e duhura disiplinore në rastet e plagjiaturës/kopjimit në procesin e provimit. Këshilli i Etikës shqyrton rastet e plagjiaturës, duke aplikuar masat e duhura disiplinore (evidenca 3 "Rregullorja e FSHJMN").			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Juridik" (evidenca 5) ka të përcaktuar afatin e korrigjimit të provimeve dhe dhënien e rezultateve përkatëse për studentët. Institucioni dhe departamenti përkatës mundëson njohjen e studentëve me rezultatet dhe tezën e provimit. Në cdo rast që studentët kërkojnë një ballafaqim me pedagogët që kanë realizuar procesin e korrigjimit, atyre ju vihet në dispozicion teza dhe cdo informacion tjetër shtesë i lidhur me këtë proces para hartimit të procesverbalit përfundimtar. Gjatë seancë sqaruese/informuese mund të bëhen dhe ndryshimet/pasqyrimet korrekte të rezultatit (RVB, fq. 36).			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.				
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në bazë të nenit 66 të rregullores së programit të studimit, realizohet dhe procesi i ankimit të studentëve për mos dakortësinë mbi rezultatin e provimit. Ky proces ka të parashikuar shqyrtimin e ankesës nga dekani, i cili mund të thyrasë për sqarime përgjegjës të departamentit, komisionin e provimit dhe studentin. Dekani gjykon nëse ankesa është e drejte apo jo dhe merr vendimin përkatës. Dekani mund të vendosë për rivlerësim të tezës së provimit ose përsëritjen e provimit dhe vlerësimin përpara një komisioni të posaçëm. Ky proces dokumentohet dhe dokumentet përkatës depozitohen dhe në sekretarinë mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Lëndët që janë pjesë e këtij programi studimi mundësojnë ofrimin e njohurive bazë në fushën e së drejtës dhe në mënyrë më specifike njohuri në fushën e të drejtës publike dhe private. Pjesë e këtij programi studimi janë dhe lëndë që mundësojnë njohuri në fushën e teknologjisë dhe informatikës sic është "Informatika" (me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>6 ECTS); lëndë të detyrueshme si lënda “Gjuhë e huaj I & II” me 4 +4 ECTS; lëndë ndërdisiplinore në fushën e ekonomisë si lënda “Economics I & II” (me 4 + 4 ECTS); lëndë që mundësojnë një komunikim dhe njohje të aspektit social të efekteve të ligjit si lënda “Sociologjia e Ligjit” (me 5 ECTS).</p>			
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Përmes këtij programi studimi studentët fitojnë aftësi praktike në disa nga lëndët specifike si p.sh (<i>evidenca 18, tabela 9 & evidenca 13.2</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> - në lëndën “Procedura civile I & II” – studentët përftojnë dijet e nevojshme që lidhen me procedurën dhe praktikën gjyqësore civile dhe një nga komponentët vlerësuese është dhe detyra e kursit; - në lëndën “Procedura penale I & II” – studentët përftojnë dijet e nevojshme që lidhen me procedurën dhe praktikën gjyqësore penale dhe një nga komponentët vlerësues është dhe detyra e kursit. 			
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik orjenton studentët në lidhje me strukturën e kontrollit të dijeve dhe formës së vlerësimit të tyre (<i>nga takimi i GVJ me stafin akademik në institucion</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik (PAE & PAK) orjenton studentët për përftimin e duhur të dijeve dhe aplikimin e tyre në praktikë përmes case study. Metoda e aplikimit në praktikë të dijeve është kryesisht në lëndët që ofrojnë njohuri specifike në fusha të së drejtës civile dhe penale.</p>			
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në lëndë specifike si “Informatike”, stafi akademik aplikon dhe orë mësimore në laborator, për një aftësim më efektiv të studentëve me njohuri bazë në këtë fushë. Si pjesë e këtij programi është dhe lënda “praktika”, e cila zhillohet në vitin e tretë akademik (me 6 ECTS) dhe që mundëson një aplikim në praktikë të njohurive të marrë përgjatë studimeve (<i>evidenca 18/tabela 10</i>).</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe udhëzuar të posacëm për zhvillimin e praktikave mësimore (<i>evidenca 39 “Udhëzues për praktikat”</i>), i cili mundëson për studentët marrje në informacionit të nevojshëm për realizimin, monitorimin dhe vlerësimin e praktikës.</p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Institucioni (UMSH) nxit përmes aktiviteteve të ndryshme frymën inovative tek studentët. Institucioni organizon aktivitetet me fokus “inovacionin”, sic është panairi që organizohet me këtë fokus “Panairi i Ideve”, në të cilin prezantohen punimet e studentëve, të cilat janë mbështetur dhe nga stafi akademik (<i>faqja web</i>). Në të njëjtë formë, institucioni mbështet dhe inkurajon studentët për pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuar nga strukturat përkatëse (<i>evidenca 22</i>).</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>				
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni organizon forume dhe konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucione të tjera në partneritet. në mbështetje të procesit mësimor (<i>evidenca 22</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.8

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Njësitë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Juridik”, hartojnë për studentët programin orjentues për provimin përfundimtar. Ky program orjentues shoqyrohet dhe me literaturën përkatës, mbi bazën e së cilës hartohet dhe teza e provimit. Programi hartohet nga departamenti përkatës në bashkëpunim me stafin akademik që do të angazhohet në këtë proces. Studentët informohen mbi këtë proces edhe përmes udhëzuesve përkatës dhe njoftimeve që bëhen publike në ambientet e institucionit. Sekretari mësimore, informon studentët për datat dhe procedurën përkatëse (evidenca 3 & 9).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Stafi akademik dhe strukturat e tjera ndihmëse akademike orjentojnë studentët në lidhje me provimin final. Programi orjentues i hartuar nga stafi akademik i vihet në dispozicion studentëve që gjatë fundit të semestrit të pestë akademik. Ky program orjentues dhe literatura përkatëse, depozitohet dhe në bibliotekën e institucionit. Provimi i formimit përmban njohuri të përgjithshme në masën 40% dhe njohuri të profilizuara në masën 60 %. Këto njohuri janë të lidhura me dijet e dhëna përmes lëndëve/moduleve, që janë pjesë e këtij programi studimi.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në bazë të rregullores së FSHJMN (evidenca 3), njësia bazë (dep.civil & publik) ngre komisionin përkatës për këtë provim dhe menazon procesin, nga hartimi i tezës deri në vlerësimin përfundimtar të studentëve. Komisioni i ngritur harton tezën nga fondi i pyetjeve të hartuara, sipas fushave specifike. Teza firmose nga departamenti përkatës, përgjegjës për programin e studimit dhe miratohet nga dekani i njësisë kryesore, që në këtë program studimi është FSHJMN. Studentët kanë të drejtë të përdorin mjediset e institucionit, gjatë kohës së përgatitjes së tyre për provimin final.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Në bazë të rregullores së FSHJMN (evidenca 3), njësia bazë (dep.civil & publik) ngre komisionin përkatës për këtë provim dhe menazon procesin, nga hartimi i tezës deri në vlerësimin përfundimtar të studentëve. Komisioni i ngritur harton tezën nga fondi i pyetjeve të hartuara, sipas fushave specifike. Teza firmose nga departamenti përkatës, përgjegjës për programin e studimit dhe miratohet nga dekani i njësisë kryesore, që në këtë program studimi është FSHJMN. Studentët kanë të drejtë të përdorin mjediset e institucionit, gjatë kohës së përgatitjes së tyre për provimin final.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në programin e studimit Bachelor në “Juridik”, aplikohet mbrojtja e diplomës përmes provimit të formimit. Ky provim është me 8 ECTS dhe zhvillohet në përfundim të të gjithë detyrimeve të tjera akademike. Provimi i formimit organizohet nga dy njësitë bazë përgjegjëse përgjegjëse për këtë program studimi (Dep.civil & publik).
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Njësitë bazë mbështesin nëpërmjet stafit akademik (PAE & PAK) gjithë procesin, që nga hartimi i literaturës së nevojshme për studentët, deri tek vlerësimi përfundimtar i tyre. Procesi mbështetet dhe nga struktura të tjera akademike dhe ndihmëse akademike të institucionit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Institucioni pajisë studentët me dokumentacionin përkatës (diplomën dhe listën e notave), të cilat tërhiqen nga studentit përmes sekretarisë mësimore, e cila evidenton këtë proces në regjistrat përkatës (nga vizita në institucionin e GVJ-së, në sekretarinë mësimore). Studenti pajisë me dokumentacionin përkatës përmes kërkesës që depoziton në sekretarinë mësimore sipas rregullave të përcaktuara në aktet përkatëse të institucionit (evidenca 3, 5, 7 & 9).
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ruan dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, në lidhje me vlerësimet e studentëve. Në sekretarinë mësimore të
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	institucionit gjenden regjistrat dhe procesverbalet e vlerësimit të studentëve. Sekretaria mësimore, si një ndër strukturat administrative të institucionit vë në dispozicion të studentit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm (<i>eidenca 9 "Rregullore e sekraterisë mësimore" & nga vizita në institucion e GVJ-së "në sekretarinë mësimore"</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Institucioni ruan të dhënat lidhur me rekrutimin e stafit akademik akademik si dhe personelit ndihmës akademik e administrativ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. (Statuti & Rregullorja e organizimit). Të dhënat rifreskohen me informacione që lidhen me vlerësimin periodik, rinovimin e kontratës, etc. Gjatë vizitës në institucion GVJ konsultoi disa dosje të personelit akademik, kontratat tip të punës së stafit akademik efektiv dhe me kontratë të firmosura nga palët, bashkë me aneks kontratën ku përcaktohen lëndët dhe orët që duhet të zhvillojë një pedagog. Të dhëna mbi personelin akademik PAE dhe PAK të angazhuar pranë programit disponohen gjithashtu nga ana e Departamenteve që janë përgjegjës për programin Bachelor, sipas planit mësimor të këtij programi me ndarjen e ngarkesës e numrin e orëve mësimore të cdo pedagogu përkatësisht sipas lëndëve, semestrave dhe vit akademik, përfshirë edhe angazhimin e personelit ndihmës-akademik e atij administrativ. (<i>Evidenca- Kontrata e punës PAE dhe Kontrata e punës PAK; Evidenca 13.1 & 3.2</i>).
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Rekrutimi bëhet në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës për njoftimit, procedurën e rekrutimit, lidhjen e kontratës e termat e saj etj. Rregulla mbi mënyrën e përcaktimit të nevojave për punësim, autoriteteve që përcaktojnë kriteret, ngritjen e komisioneve ad-hoc e komposimin e tyre gjenden edhe ne Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Për vlerësimin e kandidatëve ngrihet një komision i posaçëm i përbrerë nga Dekani, drejtuesi i departamentit dhe përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Pas shqyrtimit të dosjes së kandidatëve zhvillohet edhe intervistë më gojë. Kandidati fitues firmos kontratën e punës me rektorin e UMSH. (<i>Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH, Evidenca 29, Kontrata e Punës PAE</i>)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në Statut dhe Rregulloren e Institucionit përcaktohet procedura e rekrutimit për personelin e ri akademik që nis nga identifikimi i nevojave nga ana e njësi-ve bazë (departament) në fillim të vitit akademik. Dekani i fakultetit ia përcjell këto Zyrës së Burimeve Njerëzore për të vijuar më tej me procedurat e konkurimit. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Publikimi i thirrjes bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në faqen eeb të institucionit. Sipas të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore në muajin prill të cdo viti rikujton departamentet për të berë vlerësimin e nevojave në lidhje me personelin akademik.</p> <p>GVJ rikujton mbajtjen në vëmendje të arritjes së kufirit 70% të mbulimit të ngarkesës së programit me personel PAE.</p> <p><i>(Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH, Evidenca 29)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentave themelore te institucionit, Statut e Rregullore, rekrutimi i personelit të ri akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me nevojat e cdo departamentit, përmes komunikimit të nevojave në fillim të çdo viti akademik nga ana e Departamenteve në nivelin e Fakultetit dhe më tej pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, duke përcaktuar njëkohësisht edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin. GVJ nxit mbajtjen në vëmendje të lidhjes së ekspertizës akademike apo profilit profesional të personelit që rekrutohet me disiplinën ku angazhohet, objektiv ky në vëmendje të vecante të insitucionit në dy vitet e fundit akademike gjatë të cilit janë bërë përjpekje të dukshme për të angazhuar personel me edukim të posacëm, kompetenca dhe formim akademik të duhur për disiplinat ligjore ku afrojnë mësimdhënie.</p> <p>Në lidhje me përgatitjen e personelit akademik të rekrutuar, Institucioni punon dukshëm për të afruar personel akademik me edukim në institucione arsimore jashtë vendit e me kualifikime në lidhje me programin e studimit. Në programin e studimit janë angazhuar si staf akademik me kontratë: gjyqtarë, pedagogë nga universitete të tjera publike të vendit, etj. <i>Sidoqoftë, GVJ nxit institucionin që në politikën e tij të rekrutimit sidomos të PAK, të vazhdojë përjpekjet positive të dy viteve të fundit akademike për të miniminuar rastet e angazhimit në mësimdhënie të personel akademik pa ekspertizë apo me profil të largët profesional në disiplinat ligjore ku janë angazhuar në vite.</i></p> <p>Konkurrimi është i hapur dhe bëhet sipas një procedurë me 2 faza të përshkruar në thirrjen e publikuar e gjithashtu në Statut dhe në Rregulloren e brendshme. Insitucioni nxit përgatitjen e vazhdueshme të personelit të angazhuar nëpërmjet organizimit të aktiviteteve periodike apo krjimit të lehtësirave për personelin për pjesmarrje në aktvitete profesionale. Mbetet e rëndësishme mbajtja e raportit PAE/PAK në masën 70%/30% për mbulimin e ngarkesës së lëndëve të këtij programi që Institucioni duket se e ka arritur në dy vitet e fundit akademike (Shih të dhënat në Standartin II/). Institucioni ka bërë një punë të dukshme në këtë drejtim duke ju afruar pothuajse plotësisht këtij kufiri për cdo vit akademik nën vlerësim duke treguar vullnetin dhe potencialin për të arritur dhe ruajtur kufirin ligjor të 70%.</p> <p><i>(Evidenca 29, Evidenca 18, Tabela 4, Ngarkesa totale e personelit akademik sipas viteve)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Infrastruktura e institucionit është e përshtatshme për zhvillimin efektiv të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse. Godina ku zhvillohet aktiviteti mësimor përmban auditore në madhësi 100-120 vende si salla leksionesh por edhe për aktivitete të tjera, salla seminaresh, laboratorë etj. Sallat janë të pajisura me ndricim e aksesorë të duhur teknologjike për zhvillimin normal të aktivitetit përkatës, ndërkohë që një pjesë e hapësirës anësore të të gjitha sallave është me dritare e ballkon me ajrosje e dritë. Ambjentet e institucionit janë të një cilësie të lartë e spikasin qartë në vlerësimin e aktiviteteve që zhvillohen në to. Hapësirat janë të pajisura me ndricim alternativ në rast ndërprerje të energjisë elektrike; gjithashtu në cdo kat të godinës janë të instaluar pajisjet mbrojtëse kundër zjarrit. (Evidenca 16, Evidenca 17, Evidenca 18/Tabela 17, Evidenca 27)
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë vizitës së GVJ-së në institucion, personeli akademik i kontaktuar u shpreh pozitivisht mbi mbështetjen e institucionit në drejtim të kualifikimit e zhvillimit të mëtejshëm profesional. Institucioni organizon periodikisht aktivitete të karakterit shkencor si konferenca, seminare, leksione të hapura të personaliteteve të ftuar në të cilat nxitet në rradhë të parë pjesëmarrja e personelit akademik të Institucionit. Institucioni ka revistën e tij shkencore ku mundësohet dhe nxitet botimi shkencor i personelit akademik të Institucionit. Institucioni rezulton të ketë marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike të rajonit e më gjerë në të cilat përfshihen edhe mobiliteti i personelit akademik. Përpjekje gjithashtu evidentohen në drejtim të fitimit të projekteve nëpërmjet programin Erasmus që mundësojnë mobilitet edhe të studentëve. Gjatë takimeve me stafin akademik efektiv u përmend se ekziston mundësia e mbështetjes financiare të pjesëmarrjes në aktivitete të personelit akademik, përfshirë edhe financime të botimeve të tyre, etj. (Evidenca 7, Evidenca 19, Evidenca 23, Minutat e takimeve të GVJ në UMSH, Faqja e web e revisës https://www.umsh.edu.al/c/69/revista-euro-mediterranean)
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Kualifikimi i mëtejshëm profesional në drejtim të metodave të mësimdhënies u raportua nga ana e personelit akademik si në fokus të institucionit nëpërmjet trainimeve të posacme pas punësimit. Sipas të dhënave nga Zyra e Marrdhenieve me Jashtë, institucioni është i angazhuar në disa aktivitete trainuese që lidhen si me programin Erasmus si dhe po punohet për një projekt madhor për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me afrimin me biznesin... Në këtë drejtim, mund të vlerësohet nevoja për rritjen e burimeve njerëzore pranë Zyrës së Marrëdhënies me Jashtë për të menaxhuar aktivitetet trainuese, rezulton aktualisht të përfshijë vetëm një person. (Evidenca 1, Statutit i UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH, RVB)
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Programi nën vlerësim është riorganizuar në program të integruar të nivelit të dytë sipas parashikimeve ligjore. Sidoqoftë, më takimet me përfaqësuesit e Institucionit mund të thuhet UMSH reflekton angazhim në përdorimin efikas të burimeve njerëzore dhe trajnimin e tyre. Në kushtet aktuale kur mësimi dhe aktivitete të tjera janë online, situata

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


	nuk favorizon organizime megjithëse duhet thënë që UMSH ka realizuar disa aktivitete online gjatë kohës së pandemisë, duke nxitur performancën në lidhje me programin por dhe interesin në zhvillimin e debateve të natyrës ligjore. (Evidenca Raporti Vjetor 2019-2020, Evidenca 17, Evidenca 18/Tabela 17, minutat e e vizitës së GVJ në UMSH)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni i përmbush kënaqshëm kërkesat në lidhje me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programeve të ciklit të parë apo të dytë të studimeve; spikat në cilësinë e mjediseve, përshtatshmërisë së sallave të leksioneve, aksesit të lehtë të studentëve etj. Ka një vendndodhje të qëndrueshme që përfshin si mjedisin qendror administrativ dhe mjedisin ku zhvillohet veprimtaria mësimore. (Evidenca 19, Evidenca 27, Vizita e GVJ-së në UMSH)
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në lidhje me natyrën e kurrikulës së programit, mund të thuhet se institucioni ka mjediset të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive akademike e shkencore; në godinë janë vendosur laboratorë, salla studimi, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj. Sallat janë të pajisura me ndricim e aksesorë të duhur teknologjie për zhvillimin normal të aktivitetit përkatës, etj. Ambjentet e institucionit janë të një cilësie të lartë e spikasin qartë në vlerësimin e aktiviteteve që zhvillohen në to. (Evidenca 19, Evidenca 27, Vizita e GVJ-së në UMSH)
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UMSH ka infrastrukturën e përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, apo aktiviteteve të tjera në mënyrë optimale. Sallat mësimore që u vizituan pranë institucionit përmbajnë mjete audio-vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, ku përfshihen video projektorë, sistem fonie, sistem kondicionimi, flipcharte, etj (Evidenca 19, Evidenca 27, Vizita e GVJ-së në UMSH)
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Për t'i ardhur në ndihmë studentëve, në godinë gjendet salla e Laboratorit kompjuterik me kapacitet rreth 40 vende. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore. Personeli IT ka ofruar asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik veçanërisht gjatë periudhës së mësimin online. (Evidenca 19, Evidenca 27, Vizita e GVJ-së në UMSH)
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave	Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, mund të thuhet se UMSH ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike apo veprimtari të posaçme vetë ose edhe në bashkëpunim me institucione të tjera. Pranë tij është ngritur së fundmi edhe Klinika e Ligjit që ofron mundësi shumë të mira për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve të programit të Drejtësisë.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<i>Evidenca 19, Evidenca 27, Evidenca 39, Vizita e GVJ në UMSH, Raporti GVB)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMSH ka ngritur një bibliotekë të pasur me rreth 4000 tituj në fushën e drejtësisë. Titujt propozohen nga ana e njësisve pranë Administratorit dhe strukturës mbështetëse. Në funksion të këtij objekti është dhe Revista Shkencore e Institucionit, e cila ka mundësuar publikimin, mbështetjen e pedagogëve të ndryshëm për botimin e teksteve të tyre, kryesisht punim monografik apo punim doktore. Studenët kanë gjithashtu mundësi të shfletojnë online katalogun elektronik të titujve duke bërë në këtë mënyrë kërkim individual. Cdo studenti i mundësohet literatura e kursit përkatës në bibliotekë, pra asnjë student nuk është i detyruar të shpenzojë për literaturën e lëndës përveç nëse e dëshiron këtë. Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore. Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit të lidhura me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. <i>(Evidenca 17, Raporti i GVB, Vizita e GVJ në UMSH)</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në bibliotekën e UMSH, literatura fizike përmban tituj të botimeve vendase dhe të huaja, ku ndër ta shfaqen edhe tituj që i përkasin fushës juridike, e që janë të disponueshëm për pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, ku bën pjesë dhe literatura e detyrueshme e programit të studimit dhe e teksteve të Departamentit. Përveç asaj fizike, Institucioni ka mundësuar aksesin e studentëve dhe pedagogëve në bibliotekën online nëpërmjet një account të personalizuar për secilin prej tyre. <i>(Evidenca 17, Vizita e GVJ në UMSH, faqe e bibliotekës në web).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	UMSH ofron mundësi për akses të barabartë të studentëve në bibliotekën online, pa pagesë, ku platforma kryesore online për këtë program studimi është Questia. Aksesin në bibliotekën online është efikas dhe i mundur për cdo studente e pedago, pa pagesë gjatë 24 orëve. Sistemi mundëson leximin direkt nëpërmjet sistemit dhe printimin e materialeve nga pedagogët dhe studentët. <i>(Evidenca 17, RVB, Vizita e GVJ në UMSH, faqe e bibliotekës në web).</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e Fakultetit përfshin pajisje kompjuterike. Ajo përmban literaturë profesionale juridike kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit nga ana e studentëve. Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid -19, një mundësi e mirë për ta dhe stafin akademik mbetet biblioteka online e UMSH të cilën studentët mund ta aksesojnë pa pagesë në çdo kohë. <i>(Evidenca RVB, Vizita e GVJ në UMSH, faqe e bibliotekës në web).</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nuk rezulton një dokument plan formal për zërat e rinj, por pasurimi i fondit të bibliotekës me tekste apo materiale të tjera plotësuese në fushën juridike mbetet në objektivat kryesore të institucionit për qëllime të programit të drejtësisë. Plotësimi i titujve bëhet mbi bazën e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	kërkesave dhe nevojave që evidentohen nga departamenti, në mbështetje të programit të studimit. (<i>Evidenca Minutat e takimeve të GVJ në UMSH</i>).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka punon gjatë orareve të përcaktuara nga e hëna në të premte, dhe ditën e shtunë. Ky orar është dhe i afishuar në hyrje të bibliotekës. Cdo student ka kartelë regjistrimi. Ky orar shërbimi vlen për të gjithë studentët e UMSH. Situata e pandemisë dhe zhvillimi i mësimin dhe aktiviteteve të tjera online kanë reduktuar përdorimin e ambienteve fizike të bibliotekës. (<i>Evidenca RVB, Vizita e GVJ në UMSH</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMSH disponon një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga Hyrja/regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, informacion që mbahet në database përkatës. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit, si dhe shërben për të nxjerrë edhe statistika (<i>Evidenca 9, RVB, vizita e GVJ në UMSH takimi me Sekretarinë Mësimore</i>)
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i informacionit shërben edhe për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me aktivitetin akademik të stafit dhe personelit administrative. Ky informacion menaxhohet nga struktura të ndryshme si: Administratori, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria dhe struktura/shërbime të tjera specifike) (<i>Evidenca 9, RVB, vizita e GVJ në UMSH takimi me Sekretarinë Mësimore</i>).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sipas dokumentacionit dhe informacionit në Institucion, ky program studimi nuk ka akses të dedikuar në informacione e dokumente për personelin, studentët e këtij programi. Sidoqoftë, Institucioni ka ngitur një sistem online për qëllime të procesit mësimor ku ruhen të dhënat e procesit mësimor për lëndët e programit, provimet, rezultatet për cdo student, etj. Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional disponon dosjet me të dhënat mbi personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie (PAE dhe PAK), formën e punësimit, kontratat e tyre, rinovimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës, lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar. Ky informacion bëhet edhe pjesë e analizave dhe raporteve në nivel njësie apo institucioni (<i>Evidenca 9, Evidenca 17, vizita e GVJ në UMSH takimi me Sekretarinë Mësimore</i>)
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të	Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, Institucioni ka vënë në dispozicion të studenteve dhe stafit të angazhuar në program, sistemin e menaxhimit të mësimdhënies online në platformën Google, ku studentët dhe pedagogët në këtë sistem kanë akses të dedikuar në lëndët, në zhvillimin e mësimin, apo të provimeve, etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sipas studentëve, ky sistem ka funksionuar normalisht pa vështirësi; për studentë të pamundur për përdorimin e tyre sipas informacionit në Institucion është mundësuar konsultimi në periudha në posacme. (Evidenca 9, Evidenca 17, vizita e GVJ në UMSH takimi me Sekretarinë Mësimore)			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nga komunikimet me drejtuesit e programit gjatë vizitës së GVJ-së në MBSH (Dekani, përgjegjësi i departamentit e sekretaria mësimore,) u përçoll informacion në lidhje me efikasitetin dhe përdorimin aktiv e në kohë reale të sistemit të menaxhimit sidomos nga ana e Sekretarisë Mësimore. (Evidenca Minutat e vizitës së GVJ në UMSH)			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen e ëeb të UMSH janë përfshirë informacione mbi programin e studimit, personelin akademik aktivitetin mësimor, jetën studentore, aplikimet për bursë, të dhëna mbi klinikën ligjore, aktivitete shkencore e bashkëpunimet e institucionit, botimet në Revistën EuroMediterranean, etj. Këto materiale janë në gjuhën shqipe, si gjuhë kryesore dhe atë angleze. Në këtë faqe aksesohet edhe portali i studenteve dhe gjithashtu biblioteka online bashkë me manualin e përdorimit të saj. (Evidenca: https://www.umsh.edu.al)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni është themeluar nga Qendra Mesdheu, subjekt i Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, "Për Organizatat Jo Fitimprurëse", i ndryshuar. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar Institucioni përpilon raportet të përvitshme financiare që paraqiten Bordit të Qendrës. Bordi i Qendrës kërkon informacione periodike në lidhje me mënyrën e përdorimit të të ardhurave sipas një procedure të parcaktuar në Rregulloren e Qendrës Mesdheu. (Evidenca 1, Statutit i UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH, Raporti vjetor i UMSH 2019-2020)
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar Institucioni përpilon raportet të përvitshme financiare. Burimet kryesore të të ardhurave janë kontributet nga studentët, grantet e përfituara nga projekte të ndryshme. Financimi, menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohen në Pasqyrat Financiare të tij. Sipas Raportit Vjetor të UMSH për 2019-2020, kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm e Institucionit. Auditimi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31. Drejtimet e shpenzimeve të planifikuara për cdo vit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>akademik nën vlerësim përqëndrohen në përmirësimin e trajtimit të personelit akademik, përmirësimin e infrastrukturës në lidhje me kushtet e punës, mësimdhënien, kërkimin shkencor, projekte shkencore, shpenzime në investime dhe teknologji, bursa, etj. (Evidenca: Raportit Vjetor të UMSH për 2019-2020, Tabela 10, Evidenca 17)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas informacionit në institucion dhe atij të dorëzuar, veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm që realizohet nga një kompani auditimi e certifikuar; në Raport paraqitet e gjithë situata financiare e përdorimit e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të ofruara. Sic evidentohet dhe më sipër, kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësi e auditimit të brendshëm e Institucionit. Auditimi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31. Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertët e jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria Croëe Horëath AL shpk. Raporti financiar paraqitet në formën e një analize të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët. (Evidenca 17, Raportit Vjetor të UMSH për 2019-2020, Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31)</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar UMSH dokumenton raportet financiare për 3 vitet e fundit akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. (Evidenca 17, Evidenca 18/Tabela 18, Raporti Financiar 2018-2019, 2019-2020)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Në kushtet aktuale mund të thuhet se reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron për mbështetjen e programit të studimit; perspektiva është e lidhur edhe me numrin e studentëve që do ta zgjedhin institucionin për të vijuar studimet në fushën e drejtësisë, që mbetet ende një degë e kërkuar. (Evidenca 17, Evidenca 18/Tabela 18)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Drejtësi (i riorganizuar për vitet në vijim në program të interguar 5-vjecar në Drejtësi) i pajis studentët me njohuri bazë e të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve në fushën e drejtësisë. Programi synon gjithashtu pajisjen e studentëve jo vetëm me njohuritë bazë shkencore dhe profesionale por edhe me shprehje të transferueshme dhe ndihmëse duke kontribuar në zgjerimin e mundësive për punësim në disa sektorë.</p> <p>Ky program ofrohet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të nxjerra nga UMSH që lidhen edhe me politikat studentore nga hyrja në dalje. Nëpërmjet politikave, kriterëve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultate sa më të larta. Zyra e karrierës ka në vëmendje lehtësimin e kalimit të të diplomuarve të tregun e punës duke mundësuar kontakte e shpërndarë informacion për mundësi punësimi në subjekte të ndryshme publike e private.</p> <p><i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 10, Evidenca18/tabela 21)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Programi është hartuar dhe zbatohet duke marrë parasysh lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fushën e arsimit të lartë fuqi në RSH. Si i tillë, ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë nëpërmjet sistemit të Maturës Shtetërore si dhe studentët e këtij program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 10, Evidenca18/tabela 21, Evidenca 38)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, përcaktohen në Rregulloren e programit në bazë të parashikimeve të kuadrit rregullator të arsimit të lartë. Parashikimet mbi këto kriteret e procedura janë dhënë qartë në mënyrë të kuptueshme dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Plani mësimor për këtë program studimi u bëhet me dije kandidatëve përmes kontaktit të drejtpërdrejtë në instucion, broshuave informuese apo dhe burimeve online të informimit në faqen Eëb të institucionit</p> <p><i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 10, Evidenca18/tabela 21, Evidenca 38)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kriterëve të vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Aplikimi për programin bëhet përmes sistemit të Maturës shtetërore në përputhje me aktet e nxjerra nga MASR për këtë qëllim. Institucioni shpall listën e kandidatëve fitues për programin dhe informacioni për raundet në vijim. Për të ndjekur programin e studimit kërkohet fotokopja e dokumentit të identifikimit (karte identiteti ose pasaporte), fotokopja e noterizuar të diplomes së Matures Shtetërore ose të deftesës së pjekurisë, së bashku me certifikaten e notave ose të një deftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në QSHA dhe dy fotografi personale. Të gjitha kriteret dhe njoftimet gjenden lehtësisht edhe në faqën eëb të institucionit. <i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", faqe web https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pranë institucionit dhe në faqen e tij në Web para fillimit të vitit akademik, vihen në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informues për t'i informuar dhe njohur ata me programin e studimit, organizimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj.</p> <p>Nuk ka informacion të posaçëm mbi student të huaj por ë kriteret e aplikimit përfshihet edhe zotërimi i një diplome studimi te fituar jashte vendit dhe te njehsuar ne QSHA. (Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 38, faqe web https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme).</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>I gjithë informacioni i nevojshëm mbi programin, broshurën e studentit, dhe sidomos kriteret e aplikimit dhe pranimit, fitimit të bursave etj gjendet në faqëe ëeb të institucionit. (Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 38, faqe web https://www.umsh.edu.al/c/109).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, përcaktohen në Rregulloren e këtij programit në bazë të parashikimeve të kuadrit rregullator të arsimit të lartë. Në informacionin mbi programin sin në broshura ashtu edhe në faqën ëeb përfshihen informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e avancimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, detyrimeve akademike, etj. Kjo mundësohet gjithashtu edhe përmes sesioneve informuese, nga departamentet në bashkëpunim me strukturat e tjera mbështetëse të UMSH. Institucioni ka strukturat e tij për pritjen e studentëve në çdo fillim viti akademik, për informimin mbi institucionin, programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit, mundësitë për programe studimi të thelluar pas diplomimit, mundësitë për njohje kreditesh, etj. Në çdo fillim viti akademik, në javën e parë të tij organizohen "Java e orientimit" ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, të drejtat dhe detyrimet, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj.</p> <p>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 10, Evidenca 14, Evidenca 38, faqe web https://www.umsh.edu.al).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Informacioni mbi programet e studimit pranë UMSH përmban gjithashtu të dhëna mbi përmbajtjen dhe organizimin e programeve kohëzgjatjen e studimeve në programin e drejtësisë, kriteret e hyrjes dhe përparimit në vite përfshirë edhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme që ata mund të kenë kryer nga studentët. (Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 10, Evidenca 14, Evidenca 38)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi ve të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e programit Bachelor në fushën e drejtësisë përfshihen të dhëna mbi kriteret dhe mënyrat e realizimit të vlerësimit të studentëve. Ky informacion përfshihet në informacionin që përcillet në javën e orientimit.</p> <p>Studentët marrin njëkohësisht informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Sipas rregullores së Institucionit, studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit; ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, pikët në çdo rubrikë, përfshirë edhe të drejtën e ankimit të rezultatit bashkë me procedurën përkatëse në vijim.</p> <p><i>Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 18/Tabela 10, Evidenca 38)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse për programin Bachelor në Drejtësi (departamentet) kanë detyrë të informojnë studentët në lidhje me kriteret e punimit të diplomës në këtë program studimi, mënyrën e shprehjes së interesit, afatet kohore, procedura e mbrojtjes, etj. Sipas informacionit të marrë gjatë takimeve në institucion, ky informacion përcillet që në fillim të programit por në mënyrë të vecantë mbahet në vemendje në fillim të vitit të fundit akademik. Departamentet miratojnë për këtë qëllim pedagogë sipas fushave të temave që do të realizohen si dhe ngrënë komisionet e jurive për qëllime të mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 18/Tabela 14, Evidenca 38)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni u vë në dispozicion studentëve udhëzues të posaçëm mbi Institucionin e UMSH dhe programin që do të ndjekin siç është Broshura e Studentit dhe i njëj me planin mësimor për këtë program studimi, përmes mjeteve dhe burimeve të ndryshme të informimit. Informacion tjetër u jepet të interesuarve në fillim të vitit akademik përmes materialeve, posterave, broshurave informuese, etj. Broshura e Studentit mund të aksesohet edhe në rrugë elektronike në faqen eeb të institucionit:</p> <p><i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 18/Tabela 14, Evidenca 38, vizita e GVJ në UMSH).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Sipas akteve themelore të programit dhe Institucionit, studenti ka të drejtë të informohet me programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen e tij, kohëzgjatjen e këtij programi MP, lëndët/modulet që zhvillohen, syllabuset e tyre, njihet me detyrimet semestrale dhe vjetore përmes plan programit mësimor apo vendimeve të nxjerra nga departamenti apo senati.</p> <p><i>(Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Juridik", Evidenca 13, Evidenca 38)</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në çdo fillim viti akademik, në javën e parë të tij organizohen Java e orientimit apo “orët e hapura” ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Po ashtu në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit, studentët marrin informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj. Ky material është përgatitur edhe elektronikisht sidomos për të përballuar vështirësitë e 2 viteve të fundit lidhur me Covid-19. (Evidenca 5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor “Juridik”, Evidenca 13, Tabelat 1, 2, 9, 10, Evidenca 38, minutat e takimit të GVJ, në UBSH).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Pranë programit zhvillohen aktivite në mbështetje të veprimtarisë akademike nga ana e Zyra Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës, Klubet Studentore, Organizimi i UMSH Alumni, etj. Mund të thuhet se aktivitetet e realizuara deri para pandemisë (përfshirë edhe disa aktivitete online gjatë pandemisë) kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve mbi mundësitë për të rrugëtuar më tej në tregun e punës. Nga insitucioni dhe studentët u evidentua se studentët marrin informacion edhe në lidhje me akreditimin e institucionit dhe programet e studimeve që ofrohen, njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës së lëshuar në përfundim të studimeve. Në mënyrë të posaçme për programin e drejtësisë, në takimin e GVJ në institucion, u përcoll informacioni se prej 1 viti (nga koha e realizimit të këtij raporti) është krijuar Bordi i Tregut të Punes, me anëtarë kryetarin e Dhomës së Avokatisë, Kryetaren e Dhomës së Noterisë, Avokate e Popullit dhe një përfaqësues nga ekzekutivi. Raportet me alumni kanë rezultuar efikase duke mundësuar punësimin e studentëve menjëherë pas diplomimit. Gjithashtu, edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se studentëve u jepet informacion i vazhdueshmë për mundësitë për punësim, përmes sesioneve informuese nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Studetëve dhe Karrierës dhe Alumni UMSH. (Minutat e takimit të GVJ në UMSH, Evidenca 16, Evidenca 37, Evidenca 38).</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në informacionet e përcjella si nga pedagogët ashtu edhe nga studentët, studentëve u vihet në dispozicion informacioni plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, veçanërisht kjo në situatën kur mësimi dhe aktivitetet e tjera akademike zhvillohen online. (Minutat e takimit të GVJ në UMSH, Evidenca 16, Evidenca 38).</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Informacioni në lidhje me këtë program studimi mundësohet si nëpërmejt sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit ashtu edhe përmes mënyrave të përshkruara më sipër, përdorimit të platformës Google, e-maileve të studentëve, në ëeb site të UMSH, etj (Minutat e takimit të GVJ në UMSH, Evidenca 17, Evidenca 38)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	UMSH mban statistika vjetore mbi numrin e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në fushën e Drejtësisë. Sipas të dhënave institucionale, nga viti akademik 2015 - 2021 janë diplomuar gjithsej 611 studentë. (Evidenca 18/Tabela 21, RVB)			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UMSH mban statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit në programin e studimit Bachelor në fushën e Drejtësisë, tërheqjet, transferimet apo mospërfundimin e vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. (Evidenca 18/Tabela 21, RVB)			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Sipas dhe sa më sipër, UMSH disponon statistika mbi ecurinë e studentëve të këtij programi, që nga pranimi deri në diplomim. Këto të dhëna bëhen pjesë e raporteve të ndryshme që hartohen si në nivel njësie si dhe janë pjesë e raportimeve institucionale. (Evidenca 18/Tabela 21, Tabela 22, Tabela 23)			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e nëpërmjet sistemit të menaxhimit por edhe duke dokumentuar rreth gjendje fizike dokumentacion që lidhet me programin. Kështu, sekretaria mban evidencë të realizimit të programit mësimor për çdo lëndë, si dokument zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimi nga pedagogu, zhvillimin e orëve dhe tematikave të parashikuara sipas syllabusit të lëndës frekuentimin e lëndëve nga studentët, provimet e dhëna, kreditet e fituara etj. Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat në përfundim depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Të dhënat e studentëve janë të pasqyruara në Regjistrin themeltar, në Regjistrin e rezultateveve si dhe në Regjistrin e Diplomave. Këto të dhëna janë edhe në database përkatës. Aksesi në këtë informacion i mundësohet lirisht studentit dhe vetëm nga personeli i autorizuar i sekretarisë. GVJ u njoh nga afër me këto të dhëna gjatë vizitës në institucion (Evidenca 9, Minutat e takimit të GVJ në UMSH me sekretarinë mësimore).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UMSH ka përgatitur analiza periodike mbi përthihjen e të diplomuarve të programit të drejtësisë në tregun e punës. Në vecanti rol të rëndësishëm luan Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH që ka mision të posaçëm mbështesë studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe t'i orientojë dhe këshillojë ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve. Zyra e Karrierës që mban kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit dhe politikë të saj. UMSH ka në fokus punëimin edhe nëpërmjet ofrimit të mundësive për punësim pranë strukturave të UMSH, sic ishte rasti i disa prej të punësuarve që takoi GVJ në institucion. (Evidenca 18/Tabela 21, Tabela 23, Evidenca 10).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në parashikimet e Statutit dhe Rregullores së UMSH, përfshirja dhe angazhimi i studentëve në proceset vendimmarrëse bëhet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera në fuqi. Studentët janë të përfaqësuar në Senat dhe kanë gjithashtu Këshillin Studentor, i cili është një organizëm i pavarur në UMSH që përfaqëson dhe mbrohet interesat e studenteve.</p> <p><i>(Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH, Evidenca 13, Evidenca 37)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas komunikimit e GVJ me studentët, UMSH garanton pjesëmarrje reale të studentëve në vendimmarrje të rëndësishme që lidhen me procesin e mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përfaqësimit studentor në organet kolegjiale të universitetit për të përcjellë zërin e studentëve.</p> <p>Kjo u evidentua edhe nga takimi me studentët e këtij programi gjatë vizitës</p> <p>Informacioni për klubet vjen nga tutoriati, pedagogje tutore për studente që u japin informacion dhe aty perplasen edhe për anketa që mund të kenë etj. Studentët raportuan edhe raste që kanë pasur një vështirësi dhe e kanë zgjidhur me kontakt me përfaqësuesit e tyre.</p> <p>Vlerësimet behen nga studentet para provimeve, behet për lende dhe për pedagog. Behen dhe focus grupe, me pyetore por në presence të tyre ë jep informacion mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj.</p> <p><i>(Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH, Evidenca 11, Evidenca 18/Tabela 22, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programet kanë përgjithësisht në vëmendje ngarkesën e studentëve brenda dhe jashtë auditorit, duke bërë një shpërndarje të kësaj ngarkese mes punës në auditor dhe jashtë tij për secilën lëndë, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Në disa nga vitet e programit në vlerësim, ngarkesa e studentëve në vitin e parë, në lëndët të kategorisë me zgjedhje mund të ishte balancuar më mirë ngarkesa e lëndës me natyrën e saj dhe sidomos raportin me lëndët e detyrueshme (lënda e studimeve evropiane, 8 kredite lëndë me zgjedhje, viti i parë). Sidoqoftë kjo është adresuar në mënyrë të përshtatshme në vitet në vijim.</p> <p>Njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfutur në një IAL tjetër është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p><i>(Evidenca 5, Evidenca 13/Tabela 1, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH).</i></p>


<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Si pjesë e organeve të përhershme institucionale studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, duke dhënë kështu kontributin e tyre me vlerë. Sugjerimet dhe kontributi i studentëve merret edhe në nivel departamenti, në mënyrë të dpd për programin konkret të studimit që ata ndjekin (i.e. pyetorët, fokus-grupe, etj). (Evidenca 5, Evidenca 11, Evidenca 12, Evidenca 26, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH)</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit, ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, si dhe ka të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve (Evidenca 5, Evidenca 18/Tabela 15, Evidenca 35, Evidenca 36).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Pranë UMSH është ngritur Zyra e këshillimit të karrierës e përbërë nga 13 pedagogë që shërbejnë edhe për tutoriatin e studentëve, mbajnë lidhjet me studentet dhe kujdesen për lehtësimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë procesit akademik deri në përfundimin e tij. Nga institucioni dhe studentët u evidentua se studentët marrin informacion edhe në lidhje me akreditimin e institucionit dhe programet e studimeve që ofrohen, njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës së lëshuar në përfundim të studimeve (Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH Evidenca 10, Raporti Vjetor 2019-2020).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet në institucion me studentët rezultojnë se studentët kanë mundësi të adresojnë shqetësimet e tyre nëpërmjet pedagogëve të tutoriatit por edhe dpd në njësitë përkatëse si dhe Këshillit Studentor. Raste konkrete u sollën si shembull, duke treguar hapat e ndjekura nëpërmjet kontaktit të pedagogut tutor, vendosjes në kontakt me njësinë dhe pedagogun përkatës, adresimin e problemit përkatës dhe trajtimit të çështjes në raport me kërkesat e rregullores dhe komunikimit efektiv të palëve (Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH Raporti Vjetor 2019-2020, minutat e takimeve të GVJ në institucion).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm,</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës që ka detyrë të posaçme këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mbështetjen e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	njësiveë bazë përgjatë procesit të Praktikave mësimore dhe profesionale dhe orientimin e studentëve drejt mundësive për punëim. Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit por edhe për thellimin e mëtejshëm të studimeve në programet Master në fushën e drejtësisë (<i>Evidenca 1, Statutit I UMSH, Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH Evidenca 10, Raporti Vjetor 2019-2020</i>).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	UMSH mban në vëmendje Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit realizon vrojtime vjetore me studentët e diplomuar dhe përputhshmërinë e diplomës me tregun e punës. Sipas Raportit vjetor 2019-2020, vrojtimi mbështetet në një anketim me telefon që bëhet për të gjithë studentët e diplomuar, duke u drejtuar pyetjet si me poshtë: a) Nëse janë në marrëdhënie pune dhe kur e kanë filluar atë; b) Nëse punojnë në profesionin për të cilin studiuuan, apo janë jashtë specialitetit; c) Nëse kanë perceptimin që paga e tyre është e nivelit të ulët, mesatar apo të lartë. Sipas vlerësimit të Institucionit në Raportin vjetor 2019-2020, përqindja e të diplomuarve që janë drejtuar tregut të punës duke u punësuar në një profil të lidhur me diplomimin arrin në rreth 80% (<i>Evidenca 10, Raporti Vjetor 2019-2020, Evidenca 18/Tabelat 25, 26</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UMSH ka adoptuar dhe zbaton politika për sigurimin e cilësisë bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH dhe Standartet Shtetërore të Cilësisë. UMSH ka përcaktuar nëpërmjet dokumentave institucionalë politikat, procedurat dhe njësitë/strukturat përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike dhe shkencore, në përmbushje të standardeve të kërkuara në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standartet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përmbushet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) që e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. NJSBCZHK vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative të UMSH. Ajo ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit</p> <p><i>(Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 7 Strategjia e Zhvillimit të Programit, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Pranë UMSH është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) si njësi në nivel universiteti. Funksionimi i saj rregullohet me rregullore të veçantë. Kjo njësi përbëhet nga drejtuesi i zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Njësia zhvillon aktivitetin mbi Rregulloren e Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, Manualin e saj, Ligjin e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e UMSH, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it. NJSBCZHK realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. UMSH ka adoptuar dhe zbaton edhe një Strategji për Sigurimin e Cilësisë strategji kjo e bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional dhe Standartet Shtetërore të Cilësisë. Strategjia e Institucionit në drejtim të zhvillimit të tij është në aktet bazë të punës Njësies.</p> <p><i>(Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike cilësinë. NJSBCZHK e gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe ka akses për të marrë dhe kontrolluar të gjitha të dhënat e nevojshme të veprimtarisë së institucionit. NJSBCZHK planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional si dhe bashkëpunon me ASCAL për trajnimin e anëtarëve të saj si dhe vlerësimin e jashtëm periodik NJSBCZHK e zhvillon punën e saj sipas një kalendari të përcaktuar, e që më pas nxjerr raportet me gjetjet përkatëse Evidenca 14.3 – Kalendar aktivitete NJSBC).</p> <p>Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike.</p> <p><i>(Evidenca 1, Statuti i UMSH, Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</i></p>


<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të UMSH-së. Institucioni ka miratuar Strategjinë e Sigurimit e Cilësisë, miratuar nga Senati Akademik.</p> <p>Objektivat strategjikë të sigurimit të cilësisë përfshijnë rritjen e vazhdueshme të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe implementimi i metodologjive bashkëkohore; si dhe zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të studimit në përputhje me tregun e punës, nevojat social – ekonomike të vendit, si dhe strategjinë për zhvillim të institucionit; me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.</p> <p>Institucioni, në përfundim të çdo viti akademik, publikon raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, pas miratimit nga Senati Akademik.</p> <p><i>(Evidenca 1, Statuti i UMSH, Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjsteve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>NJSBCZHK harton raporte vjetore në lidhje me rezultatet e monitorimit të procesit mësimor, bazuar në manualin e Institucionit për realizimin e procesit të monitorimit. Këto rezultate përcillen tek autoritet drejtuese dhe bëhen pjesë e vlerësimit të punës së personelit akademik</p> <p>Për programin e studimit Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Fakulteti harton raportin vjetor të vetëvlerësimit të programit të studimit dhe e dërgon pranë Departamenteve dhe NJSBCZHK</p> <p>Të dhënat kryesore mbi praktikën e mira dhe pikat e dobëta të cilat kërkojnë më tepër zhvillim dhe plan veprimin e propozuar, NJSBC i përfshin në raportin vjetor. Raporti Vjetor dërgohet pranë Rektoratit dhe Komisionit për Vlerësim Institucional. Rektorati e përcjell në Senatin Akademik, në të cilin bëhet objekt diskutimi dhe merren vendime për miratimin e plan veprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit</p> <p><i>(Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12- Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UMSH ka në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të tij.</p> <p>Syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik në nivel departamenti nga titullarët përkatës në bashkëpunim NJSBCZHK. Nëse vlerësohet nevoja për ndryshime në programin e studimit deri në kufirin 20 % të përmbajtjes së programit, pas vlerësimit të Departamentit, ky propozim i përcillet NJSBCZHK –së bashkë me argumentimin përkatës. NJSBCZHK pas shqyrtimit e përcjell me mendimin përkatës propozimin Senatit Akademik për vendimarrje. <i>(Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12- Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 18/Tabela 21, Evidenca 21, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK).</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia ka zhvilluar disa instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecusinë e programit të studimit. Vleresimet nga ana e studenteve për çdo lëndë të realizuar zhvillohen në mënyrë anonime para provimeve. Vlerësimet behen per lende dhe per pedagog, përfshirë edhe burimet e institucionit në funksion të realizimit të programit. Një instrument tjetër është dhe ai i focus grupeve, me pyetore por ne presence te tyre. Raporti qe behet ne fund shkon ne rektorat ata pastaj e dergojne ne departamente dhe pedagoge. Departamentet gjithashtu realizojnë vlerësim periodik të pedagogëve dhe procesit akademik. Departamentet dorezojne prane njesise kalendarin e monitorimit te pedagogeve te departamentit pra e dine paraprakisht qe ne fillim te vitit</p> <p>Vleresimet jane bëhen dhe nga njesia nëpërmjet drejtuesit. Përgjegjësit e njësive vlerësojnë sipas një formati stafin akademik të angazhuar gjatë vitit akademik, në drejtim të aktivitetit mësimor, veprimtarisë shkencore, raportit me studentët, disiplina dhe etika në punë, etj. Sipas të dhënave të Raportit Vjetor 2019-2020, dhe takimeve në institucion, gjatë 2020 NJSBCZHK ka qenë pjesë e monitorimeve të drejtuesëve të departamenteve për pedagogët e departamentit që drejton. Në bashkëpunim me përgjegjësit e departamenteve, duke marrë pjesë në vlerësimin e pedagogut të lëndës përgjatë një ore mësimore të caktuar.</p> <p>Ndikim të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit të këshillit studentor si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog.</p> <p><i>(Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 18/Tabela 24, 25, 26) Evidenca 21, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Të dhënat e përftuara nga këto vlerësime, pas përpunimit, përdoren në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij. Ky vlerësim bën pjesë në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së personelit akademik të departamentit në përfundim të vitit akademik.</p> <p><i>(Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Në mënyrë periodike, NJSBCZHK informon dekanin dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi, NJSBCZHK harton një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institucionit dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. Ky raport i bëhet me dije Senatit Akademik, i cili pasi miratimit nga Senati, raport publikohet edhe në faqen Eëb të UMSH.</p> <p><i>(Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH).</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit Grupin i Vlerësimit të brendshëm i ngritur në nivel Fakulteti harton një raport vlerësimi të brendshëm ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i përcillet NJSBCZHK dhe gjithashtu kalon edhe në Senatën Akademik. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, RVB)</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet mendimeve të shprehura në pyetësorët që organizohen për këtë qëllim në fund të çdo semestri. Të dhënat e përfuara nga këta pyetësorë shfrytëzohen për vlerësimin e performancës akademike të pedagogëve në përfundim të vitit akademik por edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij. Mendimi i tyre sic u evidentua dhe më lart sillet edhe nëpërmjet organizimit të fokus grupeve, takimeve të hapura, kontaktit me Këshillin Studentor, etj. Informacioni i mbledhur lidhet me performancën e pedagogëve, metodologjinë, nivelin e përgatitjes, literatura dhe tejcimi i saj, mbështetja nga shërbimet sekretarike dhe në tërësi mbi programin e studimit si të tillë në drejtim të objektivave që ka. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 18/Tabela 25, 26) Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UMSH përfshin të dhënat e raporteve semestrale siç janë % e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Institucioni nëpërmjet NJSBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bëhet vlerësimi me nota dhe pikë • Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare; • Bëhen vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve. <p>Për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit merr informacion nga raportet semestrale që hartohen, raporti vjetor i Departamentit dhe ndryshimet e propozuara të kurrikulës, të dhëna statistikore mbi kalueshmërinë dhe mesataren e studentëve, pyetësorët me studentët, nga praktika mësimore, vlerësimi i pedagogëve nga studentët dhe përgjegjësi i departamentit, etj. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 18/Tabela 24, 25, 26) Evidenca 21, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet NJSBCZHK -së përdor edhe metoda të tërthorta vlerësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit, 1 në çdo semestër) • Fokus grupe mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj; • Vlerësimi nga ana e njëjësive bazë • Takime të hapura me studentë, tutoriali i studentevë <p>UMSH mban në vëmendje edhe studentët e diplomuar dhe përputhshmërinë e diplomës me tregun e punës, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit realizon një vrojtim vjetor në fillim të muajit mars.</p> <p>Sipas Raportit vjetor 2019-2020, vrojtimi mbështetet në një anketim me telefon që bëhet për të gjithë studentët e diplomuar, duke u drejtuar pyetjet si me poshtë:</p> <p>a) Nëse janë në marrëdhënie pune dhe kur e kanë filluar atë; b) Nëse punojnë në profesionin për të cilin studiuan, apo janë jashtë specialitetit; c) Nëse kanë perceptimin që paga e tyre është e nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.</p> <p>Sipas vlerësimit nga Institucioni të dhënat nga komunikimet e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mbi punësimin e të diplomuarve përgjatë viteve të fundit akademike, sipas programeve të studimit bachelor tregojnë një nivel të kënaqshëm punësimi në përputhje me diplomën (<i>Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 18/Tabela 24, 25, 26) Evidenca 21, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBCZHK vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative të UMSH. Ajo ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. NJSBCZHK vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen (<i>Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, minutat e vizitës së GVJ-së në UMSH</i>)</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Për strukturat, njësitë dhe autoritetet konkrete të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë për këtë program studimi, detyrat dhe përgjegjësitë janë përcaktuar në aktet e brendshme rregullore të institucionit. NJSBCZHK e zhvillon aktivitetin e saj sipas planit kalendar të vitit akademik duke parashikuar kontrollin në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/vlerësimit. Në bazë të këtij plani organizohen dhe detyrat në nivelin e institucionit dhe të njëjësive për të mundësuar përmbushjen e tij. Sipas të dhënave nga Institucioni, NJSBCZHK informon periodikisht rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, dhe personelin e UMSH rreth rezultateve të kontroleve dhe monitorimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, Raporti vjetor i UMSH 2019-2020)</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njëjësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për sigurimin e cilësisë, UMSH ka ngritur strukturat përkatëse që shkojnë deri në nivel departamenti, që merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur, në përputhje me aktet e NJSBCZHK dhe kuadrin ligjor mbi sigurimin e cilësisë. Sipas të dhënave nga takimet në institucion dhe në aktet e NJSBCZHK, vlerësimi zhvillohet në bashkëpunim me struktura ta caktuara institucionale dhe në këtë proces përfshihen edhe anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 18/Tabela 21, Evidenca 21, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vlerësimi është transparent dhe i ngritur mbi një experiencë disa vjeçare të Njësisë. Ndër parimet e punës përfshihet mbledhja e të dhënave nëpërmjet proceseve të besueshme në respektim të kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të çdo subjekti, mosdiskriminim e respektimin e integritetit akademik (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vryra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Siç u përmend më sipër edhe tek kriteri 1, në procedurat e brendshme të cilësisë përfshihen aktorë të brendshëm të institucionit si pjesë e personelit akademik dhe studentëve. Nga të dhënat e vëna në dispozicion të GVJ nuk rezultojnë përfshirja e ndonjë eksperti të jashtëm. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 21, Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Sipas akteve të institucionit, NJSBCZHK vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të UMSH si dhe harton raportet përkatëse të cilat diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Të dhënat e vlerësimit periodik NJSBCZHK i publikon në faqen zyrtare të UMSH pas miratimit nga Senati Akdemik. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UMSH publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit duke mbajtur në vemendje kërkesat ligjore mbi integritetin e personelit akademik ruajtjen e të dhënave personale, promovimin e lirisë akademike dhe etikës akademike. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK)</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raporte me rezultatet e vlerësimit diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Në bazë të këtyre raporteve, Institucioni harton raportin vjetor ku adresohen gjetjet e procesit të vlerësimit në drejtim të mbajtjes në vemendje për vitet në vijim dhe objektivat për arritjen e tyre. (Evidenca 1, Statuti i UMSH, Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Raporti vjetor i UMSH 2019-2020.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të rritjes së cilësisë Njësitë zhvillojnë raporte vjetore të performancës ku evidentohet efektiviteti i veprimtarive si dhe mangësitë që duhen adresuar në drejtim të përmirësimin të vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. (Evidenca 1, Statuti i UMSH, Evidenca 6 Plani Strategjik, Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Raporti vjetor i UMSH 2019-2020, minutat e vizitës së GVJ në UMSH).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe vizita ne institucion, rezultojnë se NJSBCZHK zhvillon takime të shpeshta me studentët, këshillin studentor, koordinatorët e Fakulteteve të UMSH, etj me focus rritjen e informacionit mbi proceset e vlerësimit të cilësisë dhe rëndësinë e tyre. Njësia mban kontakte me koordinatorët e programeve dhe i kushton vemendje të vecantë trajnimit të pedagogëve PAE dhe PAK, avancimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UMSH. (Evidenca 11 Rregullore e NJSBCZHK, Evidenca 12 Plani i Punës për Kontrollin e Cilësisë së Procesit Mësimor (2020-21), Evidenca 33 Manual i NJSBCZHK, minutat e vizitës së GVJ në UMSH)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Juridik" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë"

Pikat e forta dhe afirmime



1. Institucioni aplikon forma të përshtatshme të mësimdhënies për studentët me nevoja të vecanta.
2. Institucioni ndihmon dhe mbështet stafin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, përmes trajnimeve të ndryshme.
3. Institucioni aplikon një sistem informatik të përshtatshëm për procesin mësimor, sistem i aksesueshëm për stafin akademik dhe studentët (platformën G-suit), e përshtatshme për studentët dhe stafin akademik dhe në kushtet e pamundësisë për zhvillimin e procesit mësimor fizikisht në auditore.
4. Institucioni ka infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit akademik (formën e leksioneve, seminareve, punëve laboratorike) apo aktiviteteve të tjera ekstra kurrikulare.
5. Institucioni ofron mundësi për akses të barabartë të studentëve në biblioteka online, pa pagesë (platforma kryesore online për këtë program studimi është Questia). Aksesi në bibliotekën online është efikas dhe i mundur për cdo studente dhe staf akademikë, pa pagesë gjatë 24 orëve. Sistemi mundëson leximin direkt nëpërmjet sistemit dhe printimin e materialeve nga pedagogë dhe studentë.
6. Institucioni i vë në dispozicion studentëve udhëzues si Broshura e Studentit, duke mundësuar njohjen me planin mësimor për këtë program studimi. Broshura e Studentit mund të aksesohet edhe në rrugë elektronike në faqen ëeb të institucionit

Pika të dobta

1. Njësitë përkatëse (Dep.Publik & Civil), nuk evidentojnë përmes proces-verbaleve të mbledhjeve apo akteve të tjera administrative, aplikimin nga ana e stafit akademik të metodave të reja/innovative të mësimdhënies.
2. Institucioni/ njësitë përkatëse nuk aplikojnë përfshirjen e një eksperti të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Rekomandime:

1. GVJ i rekomandon për njësinë përkatëse, evidentimin përmes raporteve përkatëse apo proces-verbaleve të mbledhjeve të njësisë të aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies, duke mundësuar pasqyrimin e tyre në formën e dokumenteve të vlefshme për institucionin, si në kuadrin e proceseve të akreditimit, ashtu dhe në evidentimin e punës së tij të brendshme.
2. GVJ rekomandon përfshirjen e një eksperti të jashtëm në procedurat/proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.



**Conclusions of the study program Evaluation of the first cycle
Bachelor in "Law" for the Institution of Higher Education
"Mediterranean University of Albania"**

Strengths and affirmations



1. The institution applies the appropriate forms of teaching for students with special needs.
2. The institution supports the academic staff in improving the teaching methods, through various trainings.
3. The institution applies an information system suitable for the teaching process, an accessible system for academic staff and students (G-suit platform), suitable for students and academic staff and in conditions of inability to develop the teaching process physically in the auditorium (online teaching).
4. The institution has a suitable infrastructure for the development of the academic process (auditorium of lectures, seminars, laboratory work) or other extracurricular activities.
5. The institution offers opportunities for equal access of students to online libraries, free of charge (the main online platform for this study program is Questia). Access to the online library is efficient and possible for every student and academic staff, free of charge for 24 hours. The system enables direct reading through the system and printing of materials by professors and students.
6. The institution makes available to students instructions such as Student Guidelines, enabling familiarity with the curriculum of this study program. Student tutorials can also be accessed electronically on the institution's website.

Weak points

1. Relevant units (Public & Civil Departments) do not record through the minutes of meetings or other administrative acts, the application by the academic staff of new teaching methods.
2. Relevant units do not apply the involvement of an external expert in the internal quality assurance process.

Recomandations:

1. GVJ recommends that the relevant departments record through the relevant reports or minutes the implementation of new teaching methods, enabling their identification in the form of documents valid for the institution, as part of the accreditation process.
2. GVJ recommends the involvement of an external expert in internal quality assurance procedures / processes.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X